



Save the Children

Manual Vetëvlerësimi i shkollës



Tiranë, 2007



Save the Children

VLADIMIR PASKU

MANUAL
VETËVLERËSIMI I
SHKOLLËS

Tiranë 2007

Manual- VETËVLERËSIMI I SHKOLLËS

Bashkëpunim i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe
organizatës "Save the Children", Programi për Shqipërinë.

Përgatitur në kuadrin e projektit
"Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin bazë 9-vjeçar"

Autor

Vladimir PASKU, Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Redaktoi materialin: Arjana MERO

Ky libër nuk mund të shitet ose të përdoret për qëllime përfitimi. Save the Children mbështet financiarisht këtë manual, por nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e informacionit.

Tiranë, 2007

Përmbajtja

Hyrje	5
Pjesa e Parë: Vetëvlerësimi – marrëdhënie e re për përmirësimin e shkollës	7
Pjesa e Dytë: Formatit i vetëvlerësimit për shkollat e arsimit parauniversitar	17
Pjesa e tretë: Modele të plotësimit të formatit të vetëvlerësimit	45
Pjesa e katërt: Këshilla praktike për plotësimin e formatit të vetëvlerësimit	61
Si të plotësojmë një format vetëvlerësimi që funksionon	86

Hyrje

Ky manual synon të sqarojë marrëdhënien e re midis vetëvlerësimit dhe përmirësimit të shkollës. Në këtë kontekst, është për t'u përsëritur nisma e Organizatës "Save the Children" që pas publikimit të manualit "Inspektimi i plotë i shkollës" merr përsipër botimin e këtij Manuali të vetëvlerësimit të shkollës në kuadrin e zbatimit të projektit "Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin bazë 9-vjeçar" në bashkëpunim me MASH. Konkretisht, inspektorët dhe shkollat janë duke përdorur të njëjtin grup treguesish për vlerësimin e cilësisë së shkollës. Përvoja e deritanishme tregon efektivitetin e këtij zhvillimi në kuptimin e përdorimit të të njëjtës gjuhë vlerësimi nga aktorët vlerësues jashtë dhe aktorët brenda shkollës. Në këtë mënyrë janë krijuar kushtet për shndërrimin e aktit të inspektimit shtetëror arsimor në dialog konstruktiv midis palëve që kuptojnë njëra-tjetrën për përmirësimin e cilësisë së shkollës.

Projekti parashikon përfshirjen e një grupi shkollash në lëvizjen për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor që ofrojnë. Kjo nismë është në përputhje me zhvillimet bashkëkohore në fushën e vlerësimit të shërbimit arsimor që ofrojnë shkollat.

Manuali i Vetëvlerësimit të shkollës përbëhet nga formatet e vetëvlerësimit dhe udhëzimet për plotësimin e tyre. Ideja qendrore e këtij Manuali është vlerësimi objektiv që shkollat duhet t'i bëjnë cilësisë së shkollimit që ofrojnë. Kjo nënkupton faktin që stafet e tyre drejtuese duhet të identifikojnë prioritetet për përmirësim dhe të përcaktojnë objektiva të matshëm për këtë përmirësim. Kjo do të ishte rruga e vetme e përfitimit të shkollave nga inspektimi. Aq më tepër që inspektimi ofron instrumentat e nevojshëm për këtë proces.

Pjesë e vetëvlerësimit është plani i punës i shkollës. Formate të këtij mund të gjenden në Manualin "Inspektimi i Plotë i Shkollës" (botim i "Save the Children", viti 2005). Nga ana tjetër, në këtë manual është paraqitur modeli i raportit vjetor vetëvlerësues së një shkolle 9-vjeçare. Theksojmë, se formatet mund të jenë të ndryshme, unik është fakti që çdo shkollë ka detyrimin e planifikimit dhe raportimit vjetor për cilësinë e shërbimit arsimor që është duke ofruar. Cilësi, e cila sigurohet nëpërmjet procesit të gjithëpërfshirjes së komunitetit shkollor dhe aktorëve të interesuar për arsimin.

Së fundi, botimi i Manualit të Vetëvlerësimit nuk mund të realizohej pa mbështetjen e Znj. Antonieta LULI, Sekretare e Përgjithshme e MASH dhe e Z. Steve ASHBY, Drejtor i Save the Children, Programi për Shqipërinë.

Vladimir PASKU

PJESA E PARË

**VETËVLERËSIMI
MARRËDHËNIE E RE
PËR
PËRMIRËSIMIN E SHKOLLËS**

1. PSE SHKOLLAT DUHET TË PËRFSHIHEN NË PROCESIN E VETËVLERËSIMIT?

- 1.1 Shkollat kanë përgjegjësi për plotësimin e kërkesave që ka shoqëria për arsimimin e nxënësve. Por, kjo përgjegjësi duhet provuar. Shkollat e realizojnë këtë gjë nëse janë në një pozicion të tillë, i cili ofron:
- Të dhëna bindëse për sukseset e tyre;
 - Një plan të qartë pune, i cili tregon tregon rrugët e përmirësimit të gjendjes së shkollës.
- 1.2 Shkolla që përfshihet në procesin e vetëvlerësimit duhet të ketë parasysh këto katër parime themelore:
- Vetëvlerësimi korrekt e ndihmon shkollën të përmirësohet; pra, vetëvlerësimi nuk duhet të ndërmerret vetëm për të përballuar inspektimin.
 - Procesi i vetëvlerësimit duhet të jetë i thjeshtë dhe i integruar me sistemin e menaxhimit të përditshëm të shkollës.
 - Shkolla duhet të jetë e vëmendshme ndaj pikpamjeve të të interesuarve për veprimtarinë e saj dhe duhet të reflektojë ndaj tyre.
 - Të gjitha të dhënat e shkollës duhet të aktualizohen çdo vit dhe duhet të përfshijnë informacionin për efektet e punës së saj në zhvillimin e nxënësve. Deklaratat dhe lista e nismativave nuk kanë vlerë në procesin e vetëvlerësimit.
- 1.3 Shkolla e përfshirë në procesin e vetëvlerësimit duhet të jetë e aftë t'u përgjigjet pyetjeve:
- **Sa mirë jemi duke punuar?**
 - **Si mund të punojmë më mirë?**
- 1.4 Arsimiti më i mirë i mundshëm i nxënësve ofrohet, nëse stafi mësimor dhe drejtuesit e shkollës njohin në çdo kohë: sa mirë punon shkolla për nxënësit, cilët janë efektet e arsimimit të tyre dhe rrugët për përmirësimin e këtij arsimimi. Këtë gjë shkolla e siguron nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit, i cili ofron mjetet më të mira për identifikimin e pikave të forta dhe të dobësive që ka shkolla në shërbimin që u ofron nxënësve. Që këtej burojnë problemet kryesore që duhen përmirësuar.
- 1.5 Vetëvlerësimi është proces gjithëpërfshirës. Si i tillë, ai kujdeset për: a) krijimin e kulturave gjithëpërfshirëse në ndërtimin e komunitetit shkollor dhe të vlerave të përfshirjes në shkollim; b) krijimin e vlerave të përfshirjes në shërbim të një shkolle për të gjithë dhe të organizimit të përkrahjes së diversiteti; c) krijimin e praktikave të përfshirjes në shkollim për organizimin e mësimdhënies dhe mobilizimin e burimeve.

A. PËRMIRËSIMI EFEKTIV I SHKOLLËS ME ANË TË VETËVLERËSIMIT

Shpesh, vetëvlerësimi konsiderohet si një marrëdhënie e re me shkollën. Vërtet, ai është efektiv vetëm nëse bazohet në **sinqeritet, ndershmëri dhe besim**. Por, kaq nuk mjafton. Në këtë marrëdhënie të re kërkohet të ekuilibrohet dëshira për të identifikuar çdo pengesë në rrugën e shkollës për përmirësimin e cilësisë me nevojën për kapërcimin e këtyre pengesave, duke vendosur standardet më të larta të mundshme.

- 1.6 Në procesin e vetëvlerësimit shkolla grumbullon të dhëna për cilësinë e shërbimit arsimor që ofron. Këto të dhëna analizohen dhe përdoren për të:
- Diagnostikuar me saktësi pikat e forta, dobësitë dhe nevojën për ndryshim;
 - Identifikuar prioritetet kryesore të punës së shkollës;
 - Planifikuar veprimet e nevojshme për përmirësim.
- 1.7 Siç theksuam më sipër, një nga parimet e vetëvlerësimit është se shkollat duhet të kenë një plan pune, i cili përcakton qartë veprimet e nevojshme për përmirësim. Ai duhet të:
- Mbështetet në planet e mëparshme të punës, të cilët kanë pasur efekt në punën e shkollës;
 - Bazohet në një vlerësim objektiv të nevojave të shkollës; dhe
 - Përcaktojë prioritetet e zhvillimit.

Pra, plani i vetëvlerësimit, para se të përfshijë dobësitë, kërkon kryerjen e diagnostikimit të nevojave dhe të arsyeve përkatëse. Një vetëvlerësim efektiv arrin të saktësojë problemin që duhet atakuar dhe veprimet që duhen ndërmarrë për zgjidhjen e tij. Në këtë mënyrë, krijohen kushtet që veprimet e ndërmarra të kenë ndikimin më të mirë të mundshëm në zhvillimin e nxënësve.

- 1.8 Nuk ka vetëvlerësim, nëse nuk ka kontroll të efektit të aktiviteteve të planifikuara për përmirësim. Nëse aktivitetet nuk kanë efekt, atëherë kërkohen arsyet. Një analizë e tillë e brendshme sjell përmirësimin e objektivave dhe të aktiviteteve, si dhe riorganizimin e burimeve njerëzore, materiale, financiare të shkollës nëpërmjet një cikli njëvjeçar analizash. Kështu, shkolla bëhet gjithmonë e më gjithëpërfshirëse në mënyrë që në shkollim të përfshihen të gjithë fëmijët, duke përfshirë edhe grupet e fëmijëve në nevojë në procesin e të nxënësve dhe të pjesëmarrjes aktive në procesin e shkollimit. Vetëvlerësimi krijon kushtet që shkollat dhe sistemi arsimor të ndryshojnë për t'iu përshtatur larmisë së nevojave të fëmijëve.

Le të bëjmë një zbrëthim praktik të ideve të mësipërme.

2. ÇFARË DUHET TË VLERËSOJNË SHKOLLAT?

- 2.1 Cilësia e shërbimit arsimor që ofron shkolla është komplekse. Në *Manualin Inspektimi i Plotë i Shkollës* cilësia është e ndarë në katër fusha (*menaxhimi dhe administrimi i shkollës, mësimdhënia dhe mësimnxënja, kujdesi për nxënësit dhe rezultatet e nxënësve*). Secila fushë përshkruhet me anë të një grupi karakteristikash, vlerësimi i të cilave kryhet me anë të një numri të përcaktuar

treguesish dhe standardesh. Përdorimi i tyre e aftëson shkollën që në çdo kohë të dijë se sa mirë janë duke mësuar nxënësit e saj në kuptimin e:

- Standardeve të përgjithshme që arrijnë;
- Standardeve të arritura nga grupe të tilla, si vajzat dhe djemtë, nxënësit e talentuar, nxënësit në nevojë ekonomike, ata nga grupe të ndryshme etnike dhe ata me nevoja speciale mësimore;
- Progresit të grupeve të ndryshme të nxënësve, sidomos në kalimet nga një cikël në një tjetër.

2.2 Shkollat duhet të vlerësojnë cilësinë dhe efektin e:

- Zbatimit të programeve mësimore lëndore;
- Menaxhimit dhe administrimit të shkollës;
- Karakteristikave dhe objektivave, të cilat janë specifike për shkollën;
- Lidhjeve midis shkollës dhe organeve arsimore lokale, pushtetit vendor, komunitetit, biznesit lokal etj.

3. SI E VLERËSON SHKOLLA CILËSINË E SHËRBIMIT ARSIMOR QË OFRON?

3.1 Procesi i vetëvlerësimit në të cilin përfshihet shkolla për të identifikuar sukseset dhe dobësitë e saj **nuk ka formë të përcaktuar**. Shkollat janë të lira të ndjekin atë model, i cili është më i përshtatshmi për to. Megjithatë, procesi i vetëvlerësimit ka disa elementë të përbashkët për të gjitha shkollat e përfshira në të. Kështu, nga përvoja rezultojnë, se shkollat më të mira në vetëvlerësim kanë procese të thjeshta, të cilët krijojnë mundësi për matjen e progresit me rrugë praktike në jetën e përditshme të shkollës.

3.2 Partnerët e përmirësimit të shkollës (prindërit, DAR/ZA, pushteti vendor, biznesi lokal etj.) luajnë rol të rëndësishëm. Ata shtrojnë pyetje, sugjerojnë burime të dhënash dhe sfidojnë interpretimet e të dhënave të shkollës. Shkolla duhet t'i aktivizojë ata si lexues kritikë të planit të saj të punës, por *jo si autorë në shkruarjen e tij*.

3.3 Që vetëvlerësimi të jetë efektiv, shkollat duhet të kenë parasysh gjashtë pyetjet që vijojnë. Ato duhen parë me vëmendje, sepse ndihmojnë për t'u fokusuar në proces.

Pyetja 1:

Nëse shkolla është përfshirë në procesin e vetëvlerësimit, a e identifikon ky proces se sa mirë po u shërben shkolla nxënësve të saj?

1. Në themel të vetëvlerësimit të suksesshëm qëndron analiza e qartë e rezultateve të të gjithë nxënësve. Analiza e kujdesshme e rezultateve të tyre në provimet e lirisimit/Maturës Shtetërore, e rezultateve semestrale/vjetore, e raporteve të inspektimit, e projekteve vlerësuese, si ai PISA, e rezultateve në olimpiada lokale e kombëtare etj., u japin mundësi shkollave të krahasojnë standardet e nxënësve të tyre me ato të shkollave në nivel rajonal/

kombëtar. Ky krahasim krijon kushtet për vendosjen e objektivave të arritshëm në prioritetet që ka planifikuar shkolla.

2. Nga ana tjetër, shumica e shkollave zotërojnë të dhëna specifike, të cilat japin hollësi për nxënës të veçantë ose grupe nxënësish.
3. Por, rezultatet e nxënësve japin vetëm një pjesë të tablosë së zhvillimit të nxënësve. Prandaj, shkollat duhet të grumbullojnë të dhëna për fushat e:
 - Mësimdhënies/të nxënësve;
 - Kujdesit për nxënës; dhe
 - Rezultateve 3-vjeçare të nxënësve në secilën lëndë mësimore.

Pyetja 2:

Si është shkolla jonë, e krahasuar me shkollat më të mira dhe shkollat e krahasueshme me ne?

1. Shkollat e mira kanë një veçori: ato analizojnë me hollësi përvojën e tyre, duke e krahasuar me shkolla të krahasueshme ose më të mira se vetvetja. Kjo praktikë i ndihmon mësuesit të rishikojnë veprimtarinë e tyre, për të parë nëse vërtet puna që janë duke bërë është më e mira e mundëshme për nxënësit e tyre.
2. Aspektet e ndryshme të të dhënave krahasuese mund të analizohen nga këndvështrime të ndryshme. Vërtet, është e natyrshme që disa tregues janë të lartë, të tjerët mund të jenë të ulët. Por, ajo që ka rëndësi është: shkolla të kuptojë, se **prioritetet duhet të vendosen mbi bazën e të dhënave të besueshme.**
3. Stafit drejtues i shkollës duhet të jetë i qartë në përcaktimin e hapave që duhen hedhur për arritjen e objektivave. Nëse stafi drejtues i shkollës nuk është mjaftueshmërisht i fuqishëm në këtë proces, atëherë nuk është çudi që niveli i progresit të nxënësve të ketë probleme.

Kujdes!

Inspektimi e merr parasysh këtë rrethanë, kur vlerëson efektivitetin e stafit drejtues të shkollës.

Pyetja 3:

A është integruar procesi i vetëvlerësimit me sistemin tonë të menaxhimit?

1. Vetëvlerësimi nuk është sporadik. Vetëvlerësimi nuk është një aktivitet që kryhet vetëm njëherë, para se të fillojë planifikimi në fillim të vitit shkollor. Ai është i vazhdueshëm dhe është zemra e procesit të përmirësimit të shkollës. Prandaj, stafi drejtues i shkollës duhet të kërkojë vazhdimisht të dijë nëse sistemi i punës që përdor është efektiv, joburokratik dhe

lejon grumbullimin e të dhënave të duhura, si pjesë e një cikli zhvillimi dhe analize. Vetëm në këtë mënyrë, vetëvlerësimi do të jetë korrekt dhe vendimet që burojnë prej tij do të integrohen me sistemin e menaxhimit të tyre të përditshëm, veçanërisht në lidhje me:

- Performancën e stafit drejtues;
- Zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit mësimor, sidomos në kontributin e tij në përmirësimin e mësimdhënies/të nxënësve, në bashkëpunimin e departamenteve lëndore me mësuesit lëndorë për të shkëmbyer përvojën e përparuar dhe për të mësuar nga njëri-tjetri;
- Vlerësimin e gjendjes dhe vendosjen e objektivave për zhvillimin arsimor dhe personal të nxënësve.

Pyetja 4:

A mbështetet vetëvlerësimi ynë në një seri të mirë të dhënash?

1. Përvoja tregon se shkollat më efektive janë ato, të cilat organizojnë mirë grumbullimin, analizën dhe vlerësimin e të dhënave. Këto të dhëna burojnë nga:
 - **Monitorimi** dhe **interpretimi** i të dhënave të arritjeve aktuale, i tendencave që shfaqen dhe i treguesve të tjerë të arritjes për ciklet, lëndët mësimore dhe grupe nxënësish, duke përfshirë të dhënat nga provime e lirimimit/Maturës Shtetërore dhe të dhëna të kontekstit të shkollës;
 - **Grumbullimi** dhe **interpretimi** i pikpamjeve dhe mendimeve të nxënësve, prindërve, mësuesve dhe të interesuarve të tjerë për cilësinë e shërbimit arsimor të shkollës;
 - **Kontrolli** nëse objektivat e vendosura për nxënësit dhe stafin drejtues janë të guximshme, por të arritshme dhe të realizueshme;
 - **Vlerësimi** i cilësisë së formimit arsimor të nxënësve, të detyrave me shkrim dhe punimeve të tjera të tyre;
 - **Monitorimi** i rezultateve dhe i arritjeve të progresit individual të nxënësve;
 - **Vëzhgimi** dhe **vlerësimi** i mësimdhënies, përfshi edhe vlerësimin e efektivitetit të përdorimit të të dhënave të grumbulluara, për të nxitur përmirësimin e performancës së mësuesve;
 - **Vlerësimi** i të dhënave për numrin e stafit arsimor, frekuentimin e nxënësve dhe largimet nga shkolla, krahasuar me rezultatet më të mira në nivel lokal/kombëtar;
 - **Vlerësimi** i ndikimit të shërbimeve të tilla, si ai i kujdesit mjekësor, psikologut etj. në të nxënësve dhe mbarëvajtjen e nxënësve;
 - **Rezultatet** e monitorimit, të ndërmarr nga organizma shtetërore;
 - **Raportet** e komunitetit shkollor dhe agjensi të jashtme, të përfshira në punën e shkollës dhe me nxënës të veçantë.

Pyetja 5:

A janë përfshirë personat kyç të shkollës në vetëvlerësim dhe planifikim dhe a kërkojnë pikëpamjet e prindërve, nxënësve dhe e të interesuarve të tjerë për cilësinë e shkollës?

1. Stafi drejtues i shkollës i analizon në grup të dhënat dhe merr vendime për dobësitë dhe prioritetet, që vlejnë për të gjithë shkollën. Pra, vetëvlerësimi duhet të jetë sistematik dhe

- i shtrirë në të gjitha nivelet e shkollës. P. sh. mësuesit e lëndëve dhe drejtuesit e departamenteve lëndore duhet të vlerësojnë progresin e nxënësve në lëndët e tyre, të identifikojnë prioritetet që duhen mbështetur në planin e punës dhe të ndërmarrin veprime që sjellin përmirësim. Të njëjtën gjë duhet të bëjë bordi i shkollës. Ndërkaq, stafi drejtues i shkollës duhet të jetë i ndërgjegjshëm se bordi ka nevojë për mbështetje dhe trajnim për ta ndihmuar të kryejë rolin e tij.
2. Është e drejtë e çdo shkolle të vendos, se cilin do të këshillojë dhe si do t'i grumbullojë pikëpamjet. Përfshirja e nxënësve, prindëve dhe institucioneve mbështetëse është esenciale për procesin e vetëvlerësimit. Të dhënat mund të mblidhen në rrugë të ndryshme, p. sh. me anë të analizave, fokusimit në grupe të caktuara, bordit të shkollës, analizave vjetore dhe intervistave. Mund të shkohet deri te përfshirja e nxënësve për të vëzhguar dhe vlerësuar mësimet.
 3. Synimet e shkollës mund të hartohen me mbështetjen e sektorëve të këshillimit/kualifikimit. Por, në proces mund të përfshihen edhe aktorë të tjerë, si projekte të mbështetura nga donatorë të huaj, OJF etj.

Pyetja 6:

Vetëvlerësimi i ndërmarrë, a të shpie drejt aksionit për arritjen e objektivave afat-gjatë të zhvillimit të shkollës?

1. Gjatë hartimit të një plani pune të integruar ka shumë rëndësi të bëhet dallimi midis prioriteteve afat-shkurtra/operative dhe objektivave strategjike afatgjatë të shkollës. E thënë ndryshe, gjatë një viti, i gjithë stafi i shkollës fokusohet në një ose disa fusha themelore dhe në një numër të vogël detyrash. Në këtë mënyrë, bashkë me stafin drejtues, krijohen kushtet për të kontrolluar efektin e veprimit që është ndërmarrë. Natyrisht, në plan duhen integruar edhe prioritetet kombëtare/lokale.
2. Për realizimin e një vlerësimi të plotë të cilësisë ose të një aspekti të punës së saj, plani i zhvillimit të shkollës duhet të:
 - Identifikojë një numër të caktuar të prioriteteve kryesore për veprim e përmirësim, bazuar në vlerësimin e përfitimit potencial të nxënësve prej tyre. Theksojmë, se konsolidimi i një pike të fortë mund të ketë prioritet më të lartë sesa eliminimi i një dobësie të vogël;
 - Fokusohet te një përmirësim i vazhdueshëm i standardeve dhe i zhvillimit personal të nxënësve, si subjektet kryesore të përmirësimit të shkollës;
 - Përfshijë përgjegjësi të specifikuar, afate të realizimit të detyrave dhe afate të analizave të brendshme, kritere për matjen e suksesit dhe objektiva të lidhura me rezultatet dhe progresin e nxënësve;
 - Përfshijë objektivat e menaxhimit dhe të programit të zhvillimit profesional për vitin e ardhshëm shkollor;
 - Identifikojë aspektet e punës së shkollës që janë veçanërisht efektive dhe mund të kontribuojnë në përmirësimin brenda shkollës dhe në shkolla të tjera.

3. Formati i vetëvlerësimit përfaqëson një instrument shumë të rëndësishëm të vetëvlerësimit. Disa përbërës të tij janë botuar në *Manualin Inspektimi i Plotë i Shkollës*. Në formë më të plotë, ai është paraqitur në vijim të këtij Manuali. Format i vetëvlerësimit siguron një pikë nisje shumë të mirë për vetëvlerësimin. Ndërtimi i tij është udhëhequr nga rekomandimi, se edhe gjatë vetëvlerësimit, shkollat duhet të përdorin po ato fusha themelore dhe formate që përdor inspektimi gjatë vlerësimit të cilësisë së shkollës. Praktika ka treguar se shkollat pilot dhe ato të inspektuara e kanë mbështetur këtë rrugë, e cila tashmë është tipar themelor i lëvizjes globale për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë në sistemet arsimore bashkëkohore europiane.

4. Rekomandohet që shkolla ta vlerësojë cilësinë nëpërmjet vlerësimit të katër fushave:
 - Menaxhimi dhe administrimi i shkollës;
 - Mësimdhënia dhe të nxënësve;
 - Kujdesi për nxënësit; dhe
 - Rezultatet e nxënësve.Vlerësimi i tyre bëhet nëpërmjet disa formateve, të përdorshëm nga drejtuesit e shkollave dhe mësuesit në procesin e vetëvlerësimit. Modele të këtyre formateve janë përfshirë në botimin *Manual Inspektimi i Plotë i Shkollës*

5. Drejtuesit e shkollave mund t'i përdorin këto formate, kur fillojnë procesin e vetëvlerësimit. Por roli i tyre është më shumë se kaq. Ato mund të përdoren nga drejtorja e shkollës si mjete për të regjistruar interpretimet e të dhënave që kanë grumbulluar, si mjete për dialog midis drejtuesve të departamenteve dhe mësuesve. Në këto raste, rekomandohet që diskutimet të përqendrohen në suksesin e punës së shkollës në lidhje me rezultatet e nxënësve.

6. Vetëvlerësimi i nxit shkollat të demonstrojnë konkluzione të qarta, të cilat janë të mbështetura më së miri nga të dhënat. Sa herë që plotësohet një format, lajtmotivi i gjithësecilit duhet të jetë pyetja: *Si ta njohim se sa mirë jemi duke punuar?* Gjatë këtij procesi është i rëndësishëm përqëndrimi në problemet kryesore, duke shmangur arsyetimet dhe të dhënat e panevojshme.

Mbani mend!

Plotësimi i formateve përfaqëson një rrugë të disiplinuar për të testuar efektivitetin e vetëvlerësimit të shkollës dhe identifikimin e problemeve. Ky proces është një sfidë, e cila ia vlen të ndërmerret.

PJESA E DYTË

FORMATI I VETËVLERËSIMIT PËR SHKOLLAT E SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

**FORMATI I VETËVLERËSIMIT
PËR
SHKOLLAT E
SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

Shkolla: _____

ZA: _____

DAR: _____

Viti shkollor _____

HYRJE

Këto formate të vetëvlerësimit të shkollës janë hartuar për:

- T'ju asistuar në procesin tuaj të vetëvlerësimit;
- T'u përdorur si bazë të dhënash gjatë inspektimit të shkollës suaj.

Formati përbëhet nga tri pjesë:

Pjesa A: VETËVLERËSIMI

Pjesa B: INFORMACIONI FAKTIK PËR SHKOLLËN TUAJ

Pjesa C: INFORMACIONI RRETH PAJTUESHMËRISË ME
KËRKESAT LIGJORE

MIRËSEARDHËT NË FORMATIN TUAJ TË VETËVLERËSIMIT!

UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E TIJ

Gjatë plotësimit të këtij formati duhet të kini parasysh:

Formati i vetëvlerësimit është një dokument përmbledhës, që synon të regjistrojë rezultatet e procesit tuaj korrekt të vetëvlerësimit;

Nuk ka ndonjë kohë të caktuar të vitit se kur duhet plotësuar ky format. Zakonisht, është më mirë që ky proces të kryhet gjatë ciklit tuaj normal të analizës dhe planifikimit, por patjetër duhet të kryhet një herë në vit.

Seksioni B përmban të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera të nevojshme. Disa prej tyre përdoren edhe nga inspektimi (Shih *Manuali Inspektimi i Plotë i Shkollës*). Këshillohet që informacioni të përditësohet vazhdimisht.

Për cilin plotësohet ky format dhe për çfarë është?

Formati i vetëvlerësimit synon të regjistrojë rezultatet e vetëvlerësimit tuaj. Si i tillë, ai duhet të jetë një dokument diagnostikues i kujdesshëm, i cili përmban të gjitha konkluzionet, të mbështetura në të dhënat përkatëse. Formatu i vetëvlerësimit duhet të tregojë pikat e forta dhe dobësitë, si dhe problemet që duhen ndjekur për të realizuar një përmirësim efektiv të cilësisë së shërbimit arsimor që ofron shkolla juaj. Inspektorët do ta përdorin Formatin e Vetëvlerësimit gjatë diskutimit për inspektimin e shkollës suaj.

Mbani mend!

Efekti i vetëvlerësimit tuaj në përmirësimin e shkollës do të jetë një faktor i konsiderueshëm në konkluzionet e inspektorëve për efektivitetin e menaxhimit dhe të kapacitetit tuaj për t'u përmirësuar në të ardhmen.

Si të plotësohet ky format?

Këshillohet të kontrolloni informacionin që zotëroni, të plotësoni pjesën B dhe pastaj pjesën C. Informacioni i pikave B dhe C ju ndihmon në plotësimin e pjesës A.

Pjesa A, seksioni vlerësues, i korrespondon titujve të kornizës inspektuese të cilësisë së shërbimit arsimor që ofron shkolla. **Prandaj, rekomandohet që fillimisht të plotësoni seksionin e rezultateve, si dhe etikën e shkollës, të cilat shërbejnë për plotësimin e seksioneve të tjerë.**

Referenca është *Manual Inspektimi i Plotë i Shkollës*.

Secili seksion i Formatit të Vetëvlerësimit kërkon vlerësimin e aspekteve të punës suaj sipas sistemit të vlerësimit me katër nivele. Edhe inspektimi përdor të njëten shkallë vlerësuese. Ky sistem është:

<i>Niveli</i>	<i>Cilësia e vlerësimit</i>
4 <i>Shumë mirë</i>	Kryesisht suksese
3 <i>Mirë</i>	Suksese më shumë se dobësi
2 <i>Mjaftueshëm</i>	Disa dobësi të rëndësishme
1 <i>Dobët</i>	Kryesisht dobësi

Më poshtë janë paraqitur përshkrime të përgjithshme të këtyre vlerësimeve, të cilat mund të përdoren gjatë vetëvlerësimit të plotë apo interpretimit të dukurive të ndryshme në shkollë.

Shumë mirë

Vlerësimi *shumë mirë* jepet kur, në përgjithësi, karakteristikat e cilësisë janë identifikuar si të suksesshme. Ka shumë pak dobësi dhe, kur ato ekzistojnë, nuk kanë ndikim të dukshëm në efektivitetin e karakteristikës që vlerësohet. Por, vlerësimi *shumë mirë* nuk përfaqëson një nivel të jashtëzakonshëm pune. Ai duhet të karakterizojë atë nivel pune, i cili përfaqëson një realitet që mund të arrihet në të gjitha shkollat.

Mirë

Vlerësimi *mirë* jepet kur puna e shkollës karakterizohet nga shumë suksese. Ka dobësi por ato, veç e veç apo të marra së bashku, nuk shkaktojnë probleme të mëdha në efektivitetin e karakteristikës që vlerësohet. Në përgjithësi, duke analizuar të gjitha sukseset dhe dobësitë si dhe peshën e secilës prej tyre në punën e shkollës, arrihet në konkluzionin se sukseset mbizotërojnë ndaj dobësive.

Mjaftueshëm

Vlerësimi **Mjaftueshëm** jepet kur puna ka disa suksese por, dobësitë, për pasojat që kanë sjellë, mbizotërojnë ndaj sukseseve. Një gjë e tillë mund të vijë nga fakti që rezultatet, megjithëse janë të pranueshme në disa drejtime, janë të pamjaftueshme në një numër të konsiderueshëm drejtimesh të tjera. Po kështu, kjo gjendje mund të vijë edhe nga fakti që, megjithëse rezultatet janë të mira në disa drejtime, vërehen dobësi esenciale në disa fusha të rëndësishme.

Dobët

Vlerësimi **Dobët** jepet kur në punë vërehen dobësi të mëdha. Megjithë përvojat pozitive të shkollës në disa drejtime të izoluar të punës së saj, pamja e përgjithshme e shkollës dëshmon shumë dobësi në shumicën e drejtimeve të fushave dhe të karakteristikave të cilësisë.

Ka shumë rëndësi që formatin ta plotësoni me rigorozitet dhe objektivitet. Për këtë mund t'i referoheni *Manualit Inspektimi i Plotë i Shkollës*, i cili përshkruan secilin nivel të vlerësimit.

Gjatë plotësimit të hapësirave në **Pjesën A** duhet të përgjithësoni rezultatet tuaja dhe t'i ilustroni me të dhëna përkatëse, duke pasur parasysh pyetjet specifike të secilës hapësirë. Nuk është e nevojshme paraqitja e sasive të mëdha të të dhënave dhe i përshkrimeve të hollësishme. Ju duhet të përdorni të dhënat e zgjedhura me kujdes, në mbështetje të konkluzioneve për performancën tuaj.

PJESA A: VETËVLERËSIMI

1. KARAKTERISTIKAT E SHKOLLËS SUAJ

Cilat janë karakteristikat kryesore të shkollës suaj?

Gjatë plotësimit të Seksioneve B dhe C të këtij formati, shkruani një përshkrim të shkurtër të karakteristikave të saj.

Kujdes!

Kjo është një mundësi për të paraqitur një përmbledhje të shkurtër të karakteristikave kryesore të shkollës. Pra, nuk është e nevojshme përsëritja e tabelave me të dhëna.

1a Skiconi karakteristikat kryesore të nxënësve, duke përfshirë:

- Arritjet e tyre në fillim të vitit shkollor dhe si i njihni ju ato;
- Sfondin e tyre social dhe ekonomik, i cili tregon edhe nivelin e mirëqënies ose të varfërisë.

1b Paraqitni shkurtimisht synimet tuaja kryesore dhe përshkruani çdo tipar special të shkollës suaj, p.sh.:

- Nëse jeni shkollë me status special (kombëtare), ose jeni shkollë private/fetare;
- Nëse keni degë speciale, ose ofroni shërbime të veçanta;
- Nëse keni binjakëzim ose mbështetje nga donatorë, agjensi etj.

1c Përshkruani çështje specifike të kontekstit ose çështje të tjera, të cilat veprojnë si ndihmë ose si pengesa për rritjen e performancës së shkollës suaj, p.sh.:

- Vështirësitë që kini për plotësimin e stafit mësimor;
- Riorganizimi i kryer ose i pritshëm i shkollës;
- Lëvizjet e nxënësve;
- Fakte veçanërisht të rëndësishme në historinë e shkollës suaj, si ndryshimi i drejtorisë.

1d Paraqisni çdo karakteristikë tjetër të shkollës suaj, për të cilën mendoni se do të tërheq vëmendjen e grupit të inspektorëve.

1e Përshkruani shkurt prioritetet tuaja kryesore të planit të zhvillimit të shkollës suaj dhe si reflektohen ato në kontekstin në të cilin punoni.

2. PIKËPAMJET E NXËNËSVE, PRINDËRVE DHE TË INTERESUARVE TË TJERË

Cilat janë pikëpamjet e nxënësve, prindërve dhe e të interesuarve të tjerë që njihni për cilësinë e shërbimit arsimor që jeni duke ofruar?

2a Si i grumbulloni pikëpamjet e nxënësve, prindërve dhe të interesuarve të tjerë, sa shpesh e bëni këtë dhe si e siguronit objektivitetin e informacionit?

2b Çfarë ju tregojnë pikëpamjet e nxënësve, prindërve dhe të interesuarve të tjerë për standardet e nxënësve, zhvillimin dhe mbarëvajtjen personale të tyre, si dhe cilësinë e shërbimit tuaj?

2c Si i ndani me prindërit edhe të interesuarit e tjerë gjetjet e grumbulluara rreth pikëpamjeve të tyre?

2d A mund të jepni shembuj të veprimeve që keni ndërmarrë, duke u mbështetur në pikëpamjet e nxënësve, prindërve dhe të interesuarve të tjerë bashkë me një vlerësim të efektivitetit të asaj që keni kryer?

- A ka shembuj të veprimeve, për të cilët vendosët të mos i ndërmerrnit (bashkë me arsyt)?
- A ka shembuj të rrugëve me anë të të cilave të interesuarit kanë influencuar te prioritete e përmendur në pikën 1e? (Referohuni te çdo koment i pjesës së menaxhimit).

3. ARRITJET E NXËNËSVE

Sa të mira janë rezultatet e nxënësve?

Për të plotësuar këtë seksion rekomandohet të konsultoheni me faqet përkatëse të *Manualit Inspektimi i Plotë i Shkollës*.

Gjatë përgjigjes së pyetjeve që vijojnë, përpikuni të sqaroni të dhënat kryesore, si ato për performancën dhe për vlerësimet e nxënësve, në të cilat mbështetet vlerësimi juaj (këshillohet përdorimi selektiv i të dhënave, duke shmangur kopjimin e tabelave ose informacionin përshkrues).

3a Cilat janë rezultatet e nxënësve në mësimet?

- **Rezultatet** e arritura nga nxënësit sipas rezultateve të tyre në teste dhe provime, duke marrë parasysh dallimet midis grupeve të nxënësve, lëndëve mësimore, klasave, tendencës së rezultateve, krahasimet me shkollat e tjera dhe nëse nxënësit i kanë arritur objektivat;
- **Rezultatet aktuale** të nxënësve në lidhje me objektivat mësimore (duke nënvizuar çdo ndryshim të rëndësishëm midis rezultateve aktuale dhe atyre të mëparshme);
- **Progresi** relativ i nxënësve në lidhje me fillimin e vitit shkollor/fillimin e shkollës, duke nënvizuar dallimet midis grupeve të nxënësve (duke sqaruar nëse ka ndonjë **grup, i cili megjithëse ka rezultate të ulëta, mund të përmirësohet**).

3b Si janë rezultatet e nxënësve sipas *Manualit Inspektimi i Plotë i Shkollës*?

3c Në bazë të vlerësimit tuaj, cilat janë prioritetet kryesore të zhvillimit të shkollës?

3d Niveli i vlerësimit të klasës 4 të shkollës 9-vjeçare/të shkollës së mesme (këshillohet të konsultoheni me përshtkrimet e mësipërme, të marra nga *Manuali Inspektimi i Plotë i Shkollës*).

		Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
Rezultatet e nxënësve	Për shkollën				
	CF				
	CL				
	Klasa 1 ShMesme				
	Klasa 2 ShMesme				
	Klasa 3 ShMesme				
	Klasa 4 ShMesme				
	Klasa 5 ShMesme				

4. ZHVILLIMI PERSONAL DHE MIRËQËNIA E NXËNËSVE

Sa i mirë është zhvillimi i përgjithshëm personal i nxënësve?

Konsultohuni me pjesët korresponduese të Manualit Inspektimi i Plotë i Shkollës. Gjatë përgjigjes së pyetjeve, qartësoni të dhënat, tek të cilat mbështetet vlerësimi juaj.

4a Cila është shkalla e sigurisë së nxënësve në shkollë?

- Nëse nxënësit ndjehen të sigurtë nga të gjitha format e dhunës, kërcënimet ose incidente raciste;
- Klima e bashkëpunimit midis stafit dhe nxënësve. Shkalla e besimit të nxënësve për të biseduar me stafin, nëse ndjehen të rrezikuar.

4b Cila është shkalla e kënaqësisë së nxënësve në shkollë?

- Shkalla e zbatimit të rregullores së disiplinës në mënyrë të ndërgjegjshme. Konsideroni qëndrimet, sjelljen dhe frekuentimin e nxënësve;
- Zhvillimin shpirtëror, moral, social, emocional dhe kulturor të nxënësve

4c Sa mirë përgatiten nxënësit për mirëqenien e tyre të ardhme ekonomike?

- Shkalla e formimit të shkathtësive dhe cilësive personale që ndihmojnë nxënësit në këtë drejtim;
- Kontaktet e shkollës me shkollat nga vijnë/ku shkojnë nxënësit, për t'i këshilluar dhe për të zbutur kalimin e tyre;
- Kuptimet e nxënësve për karrierën dhe përfitim të shprehive të punës;
- Kontaktet e shkollës (së mesme) me institucionet që ofrojnë vende pune, për të inkurajuar

një orientim të përshtatshëm të nxënësve në tregun e punës.

4d Bazuar në vlerësimin tuaj, cilat janë prioritetet kryesore për zhvillimin e përgjithshëm personal të nxënësve?

		Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
Zhvillimi i përgjithshëm personal i nxënësve	Për shkollën				
	CF				
	CL				
	Klasa 1 ShMesme				
	Klasa 2 ShMesme				
	Klasa 3 ShMesme				
	Klasa 4 ShMesme				
	Klasa 5 ShMesme				

5. CILËSIA E MASAVE TË NDËRMARRA

Konsultohuni me materialin përkatës të Manualit Inspektimi i Plotë i Shkollës.

Vlerësimi juaj për cilësinë e shërbimit arsimor që ofroni duhet të marrë parasysh impaktin e arritjeve të nxënësve dhe zhvillimin e përgjithshëm personal të nxënësve.

Gjatë përgjigjeve të pyetjeve, qartësoni të dhëna kryesore, si monitorimi i mësimëve, mbi të cilin është mbështetur vlerësimi juaj.

5a Sa e mirë është cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies?

- Sa mirë i plotëson mësimdhënia nevojat e nxënësve dhe ato të programit mësimor;
- Përshtatshmëria dhe rigoriziteti i vlerësimeve në planifikimin e mësimnxënies dhe monitorimin e progresit të nxënësve;
- Diagnoza dhe kushtet sipas nevojave individuale të mësimnxënies;
- Përfshirja e prindërve në mësimnxënien dhe zhvillimin e nxënësve.

5b Sa mirë kurrikula dhe aktivitete të tjera mësimore përputhen me diapazonin e nevojave dhe interesave të nxënësve?

- Shkalla me të cilën tekstet alternative të zgjedhura ose aktivitetet mësimore plotësojnë nevojat e nxënësve (4.4);
- Shkalla me të cilën pajisjet e shkollës inkurajojnë nxënësit të ndjehen mirë dhe të sigurtë; (3.3/4.5);
- Shkalla e mundësive që u ofrohen nxënësve, për të zhvilluar shprehje të të mësuarit dhe të punës në grup (10);
- Shkalla e përfshirjes së nxënësve në aktivitete mësimore, në shërbim të rritjes së rezultateve të tyre (6.6).

5c Sa mirë udhëhiqen dhe mbështeten nxënësit?

- Kujdesi i përditshëm që tregon shkolla ndaj nxënësve të saj; mbështetja e tyre për rezultate të mira (8.5);
- Shkalla e veprimtarive për përfshirjen e nxënësve në mësim;
- Shkalla e vëmendjes dhe e respektit që tregojnë mësuesit ndaj nxënësve;
- Cilësia e politikës së shkollës gjatë formimit të klasave sipas potencialeve të nxënësve.

5d Bazuar në vlerësimin tuaj, cilat janë prioritetet kryesore për zhvillim?

5e Përcaktoni nivelet e vlerësimit për çështjet që vijojnë. Për këtë konsultohuni me *Manualin Inspektimi i Plotë i Shkollës*.

		Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
Cilësia e mësim-dhënies të nxënërit	Për shkollën				
	CF				
	CL				
	ShMesme				
Cilësia e teksteve alternative dhe aktiviteteve të tjera	Për shkollën				
	CF				
	CL				
	ShMesme				
Cilësia e kujdesit dhe e mbështetjes	Për shkollën				
	CF				
	CL				
	ShMesme				

6. MENAXHIMI I SHKOLLËS

Gjatë plotësimit të këtij seksioni duhet të konsultoheni me Manualin Inspektimi i Plotë i Shkollës.

Vlerësimi juaj për cilësinë e menaxhimit duhet të marrë në konsideratë impaktin e tij në rezultatet e nxënësve dhe cilësinë e masave të ndërmarra.

Gjatë përgjigjes së pyetjeve që vijojnë, paraqisni të dhënat kryesore ku jeni mbështetur.

6a Cilat janë efektiviteti dhe eficientia e përgjithshme e menaxhimit të shkollës suaj?

- Sa efektivë janë anëtarët e ekipit menaxhues të shkollës në vendosjen e drejtimeve të qarta për përmirësimin e cilësisës së shërbimit arsimorë që ofron shkolla juaj;
- Sa efektivisht monitorohet performanca dhe përmirësimi i saj në funksion të plotësimit

- të objektivave (1.4) nëpërmjet vetëvlerësimit;
- Sa mirë zbatohet parimi i barazisë së shanceve, (8.3/11.1) në mënyrë që të gjithë nxënësit të përfshihen në mësim (12.3);
- Përshtatshmëria e stafit, bazës materiale mësimore dhe e klasave, si dhe shkalla e përdorimit të tyre (3);
- Efektiviteti i lidhjeve me të interesuarit e tjerë (5.4-5.6/11.6) në shërbim të përmirësimit të mësimnxënies;
- Shkalla me të cilën anëtarët e ekipit menaxhues të shkollës ushtrojnë përgjegjësitë e tyre.

6b Bazuar në vlerësimin tuaj, cilat janë prioritetet kryesore në fushën e menaxhimit të shkollës suaj?

6c Përcaktoni nivelin e vlerësimit për fushën e menaxhimit, sipas udhëzimeve të *Manualit Inspektimi i Plotë i Shkollës*.

		Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
Efektiviteti dhe efienca e menaxhimit	Për shkollën				
	CF				
	CL				
	ShMesme				

7. EFEKTIVITETI DHE EFIÇIENCA E PËRGJITHSHME

Sa efektiv dhe eficient është shërbimi arsimor i ofruar, kujdesi për nxënësit dhe çdo shërbim tjetër, i ofruar për plotësimin e nevojave të nxënësve dhe pse?

Për t'iu përgjigjur pyetjeve që vijojnë, duhet të përdorni edhe vlerësimet në seksionet e mëparshme.

Manuali Inspektimi i Plotë i Shkollës ju ndihmon në plotësimin e dubur të këtij seksioni.

Gjatë përgjigjes së pyetjeve pasqyroni të dhënat kryesore, mbi të cilat është mbështetur vlerësimi juaj.

7a Cili është efektiviteti i përgjithshëm i shërbimit arsimor të ofruar, përfshi edhe shërbime të tjera, dhe cilat janë pikat e forta si dhe dobësitë e tij?

7b Cili është efektiviteti i çdo hapi për përmirësim qysh nga inspektimi i fundit, i ndërmarrë si rezultat i vetëvlerësimit tuaj?

7c Cili është kapaciteti juaj për të bërë përmirësim të mëtejshëm?

7d Sa efektive janë lidhjet me organizatat e tjera për nxitjen e mbarëvajtjes së nxënësve?

7e Cilat janë hapat që duhen ndërmarrë për përmirësim të mëtejshëm?

7f Përcaktoni nivelin e vlerësimit për çështjet që vijojnë, sipas udhëzimeve të *Manualit Inspektimi i Plotë i Shkollës*.

	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
Efektiviteti i përgjithshëm				
Kapaciteti për të kryer përmirësim të mëtejshëm				
Përmirësimi qysh nga inspektimi i fundit				

PJESA B: INFORMACIONI FAKTIK PËR SHKOLLËN TUAJ

SEKSIONI A: INFORMACIONI PËR SHKOLLËN TUAJ

A1	Emri i Shkollës	<input type="text"/>
A2	Tipi i Shkollës	<input type="text"/>
A3	Statusi i Shkollës	<input type="text"/>
A4	Grup moshat e nxënësve	<input type="text"/>
A5	Drejtori i Shkollës	<input type="text"/>
A6	Adresa e Shkollës	<input type="text"/>
A7	Telefoni i shkollës	<input type="text"/>
A8	Faxi i Shkollës	<input type="text"/>
A9	Adresa E-mail e shkollës	<input type="text"/>
A10	Adresa website e shkollës	<input type="text"/>
A11	DAR	<input type="text"/>
A12	ZA	<input type="text"/>

A 13 Kategoria e shkollës

Tregoni me simbolin \checkmark nëse shkolla ka aplikuar për një nga emërtimet që vijojnë:

Kategoria	Shkolla e gëzon këtë kategori	Shkolla ka aplikuar për këtë kategori	Data e emërimit
Shkollë profesionale			
Shkollë me kohë të plotë			
Shkollë me kohë të shkurtuar			
Kategori tjetër			

Më poshtë përshkruani hollësi të tjera, të cilat i mendoni të rëndësishme.

A14 Kujdesi shëndetësor në shkollë

Tregoni llojin e shërbimit shëndetësor që ofrohet në shkollën tuaj.

A15 Riorganizimi i shkollës

Tregoni nëse shkolla aktualisht është në procesin e riorganizimit. Në këtë rast, jepni shpjegimet e nevojshme.

Po/Jo

Shkolla është subjekt i riorganizimit

A16 Shkollë fetare

Tregoni nëse shkolla ka karakter fetar. Në këtë rast, jepni shpjegimet e nevojshme.

Po/Jo

Shkolla ka karakter fetar

SEKSIONI B: INFORMACION PËR NXËNËSIT

B1 Numri i nxënësve

Jepni numrin aktual të nxënësve sipas tabelës që vijon:

Cikli	Grupi / Viti	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Parashkollor	1			
	2			
	3			
Cikli fillor	1			
	2			
	3			
	4			
Cikli i lartë	5			
	6			
	7			
	8			
Shkolla e Mesme	1			
	2			
	3			
	4			
	5			
Gjithsej				

B2 Komuniteti i shkollës

Tabela paraqet numrin e nxënësve sipas etnicitetit dhe problemeve sociale të familjeve të tyre.

	Numri		Numri
Të bardhë	<input type="text"/>	Me prindër të divorcuar	<input type="text"/>
Romë	<input type="text"/>	Me nevoja të veçanta	<input type="text"/>
Egjiptianë	<input type="text"/>	Prindër me arsim të lartë	<input type="text"/>
Minoritarë	<input type="text"/>	Banues me qira	<input type="text"/>
Të tjerë	<input type="text"/>	Ardhur 10 vitet e fundit	<input type="text"/>
Gjithsej	<input type="text"/>	Gjithsej	<input type="text"/>

B3 Nxënës me vështirësi në të mësuar

Të paraqiten nxënësit sipas problemeve që vijnë:

Lloji i masave të marra	
Të përfshirë në veprimet mësimore të shkollës	
Veprimtari plus të shkollës	
Nxënës me zhvillim të vonuar (nuk përfshihen më sipër)	
Gjithësej	

B4 Natyra e vështirësive të nxënësve me vështirësi ose paaftësi në të mësuar.

Në vijim të tabelës në pikën B4, çdo nxënës të paraqitet vetëm njëherë, duke theksuar problemin që ka.

Paaftësia/vështirësia	Numri i nxënësve
Mësimnxënies specifike (disleksi)	
Mësimnxënie e moderuar	
Mësimnxënie agresive	
Mësimnxënie e thellë dhe e shumëfishtë	
Probleme sociale, emocionale dhe të sjelljes	
Probleme dëgjimi	
Probleme të të parit	
Probleme multi-sensore	
Probleme fizike	
Autizëm	
Të tjera	
Gjithësej	

B5 Lëvizjet e nxënësve

Të paraqitet niveli i lëvizjes së nxënësve në lidhje me pranimet dhe transferimet gjatë vitit të kaluar shkollor.

Numri i nxënësve të ardhur në shkollë, mbi numrin e zakonshëm të nxënësve.	
Numri i nxënësve që janë larguar nga shkolla, mbi numrin e zakonshëm që mbarojnë shkollën.	
Numri i nxënësve të regjistruar në muajin janar të vitit aktual shkollor	

SEKSIONI C: INFORMACION RRETH OBJEKTIVAVE TË NXËNËSVE

C1 Objektivat lëndore (klasa 4 CF)

Të paraqiten objektivat lëndore për vitin e kaluar shkollor dhe vitin shkollor në vazhdim.

Objektivi %:	Viti	
Nxënësit që pritet të jenë shumë mirë në gjuhë		
Nxënësit që pritet të jenë shumë mirë matematikë		
Nxënësit që pritet të jenë shumë mirë në gjuhë të huaj		
Nxënësit që pritet të jenë mirë në gjuhë		
Nxënësit që pritet të jenë mirë në matematikë		
Nxënësit që pritet të jenë mjaftueshëm në gjuhë		
Nxënësit që pritet të jenë mjaftueshëm matematikë		

C2 Objektivat lëndore (klasa 8/9 CL/Shkollë e Mesme)

Të paraqiten objektivat e shkollës për provimet e lirimt/Maturës Shtetërore për vitin e kaluar shkollor dhe vitin shkollor në vazhdim.

Objektivi %:	Viti	
% e nxënësve që pritet të jenë shumë mirë		
% e nxënësve që pritet të jenë mirë		
Nota mesatare në provime		

SEKSIONI E: INFORMACION PËR SHËRBIMIN ARSIMOR

E1a Koha mësimore

Të pasqyrohet koha e plotë mësimore e çdo jave të vitit shkollor, mbështetur në Udhëzimin e MASh për fillimin e vitit shkollor.

	Koha mësimore
Arsimi parashkollor	
CF	
CL	
Shkolla e mesme	

E2 Përshkrimi i kurrikulës

Të paraqitet çdo informacion rreth për kurrikulën që zhvillohet në shkollë, p.sh., specifika të saj, opsionet e zgjedhjes së teksteve alternative, efektet e saj në mësimdhënie/mësimnxënie etj.

--

SEKSIONI F: INFORMACION PËR STAFIN

F1 Numri i mësuesve

Të paraqitet numri i mësuesve të kualifikuar dhe të pakualifikuar me kohë të plotë në secilën kategori të tabelës.

	Me kohë të plotë			
	5 -10 vjet	10 - 20 vjet	Mbi 20 vjet	Total
Mësues të kualifikuar (përfshi drejtorinë e shkollës)				
Mësues të pakualifikuar				
Totali				

F2 Mësues për nxënësit e ngjuar dhe/ose nxënësit që frekuentojnë me hope

Mbështetur në tabelën F1, tregoni numrin e mësuesve për nxënësit e ngjuar ose ata që frekuentojnë me hope.

	Me kohë të plotë			
	5 -10 vjet	10 - 20 vjet	Mbi 20 vjet	Total
Mësues të kualifikuar për nxënës të ngjuar				
Mësues të kualifikuar për nxënës që frekuentojnë me hope				
Totali				

F3 Stafi mbështetës

Të paraqitet stafi mbështetës i shkollës, si sekretare, roje, personeli i bazës prodhuese etj.

F7 Qarkullimi i stafit mësimor

Të paraqitet numri i mësuesve me kohë të plotë, të cilët janë emëruar ose janë lëvizur nga shkolla në dy vitet e fundit shkollore.

	Totali
Numri i mësuesve që janë larguar nga shkolla gjatë dy viteve të fundit shkollore	
Numri i mësuesve që janë emëruar në shkollë gjatë dy viteve të fundit shkollore	

F8 Mësuesët me kontratë

Të paraqitet numri i vendeve bosh në organikë, të plotësuar nga mësuesët me kontratë, të ekuivalentuar në norma të plota mësimore.

	Totali
Numri i vendeve bosh në organikë, të plotësuar nga mësuesët me kontratë	

PJESA C: INFORMACION PËR PAJTUESHMËRINË ME KËRKESAT LIGJORE

Plotësoni tabelën që vijon duke pasur parasysh këto specifitime:

Në shkollë: dispozitat normative zbatohen në shkollë;

Pjesërisht në shkollë: shumica e kërkesave zbatohen në shkollë, por ndjehet nevoja për ndërmarrjen e veprimeve, siç është rasti i nxënësve që frekuentojnë me hope; ose

Jo në shkollë: Kërkesat nuk zbatohen në shkollë dhe duben ndërmarrë veprime për zbatimin e tyre (rasti i nxënësve të ngjuar ose i atyre që kanë braktisur shkollën). Në këto raste, duhet të jepen shpjegime për vendin ku zbatohen dhe veprimin që kryhet me nxënësit.

Kurrikula	Në shkollë	Pjesërisht në shkollë	Jo në shkollë
1. Çdo nxënës zhvillon të gjitha programin mësimor shtetëror që ofrohet			
2. Shkolla ofron edukim fetar për të gjithë nxënësit sipas kërkesave të programit mësimor.			
3. Shkolla ofron edukimin për aspektet e ndryshme të dhunës dhe traumës në shkollë.			
Barazia			
4. Shkolla nuk lejon diskriminimin e nxënësve dhe të stafit për arsye seksi, race, paaftësie fizike ose gjendje martesore.			
5. Shkolla zbaton një politikë për nxënësit me nevoja të veçanta mësimore dhe paaftësi fizike, e cila njihet nga prindërit.			
6. Shkolla raporton çdo vit për zhvillimin e nxënësve me nevoja të veçanta.			
Kujdesi për nxënësit			
7. Shkolla ka marrë masat për sigurinë dhe kujdesin shëndetësor të nxënësve sipas akteve ligjore përkatëse.			
Informimi i prindërve			
8. Shkolla garanton vlerësimin e zbatimit të akteve ligjore dhe rezultatet ia përcjell prindërve dhe organeve të tjera të interesuara.			

Kurrikula	Në shkollë	Pjesërisht në shkollë	Jo në shkollë
9. Shkolla garanton hartimin e një raporti vjetor për rezultatet e nxënësve, i cili i përcillet prindërve.			
Menaxhimi i shkollës			
10. Janë përcaktuar qartë përgjegjësitë e secilit anëtar të ekipit drejtues të shkollës.			
11. Ekipi drejtues i shkollës ka një politikë të qartë menaxhimi, e cila garanton vlerësimin e të gjithë mësuesve në përputhje me aktet ligjore.			
12. Ekipi drejtues ka procedura për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të ndryshme.			

Përshtuani veprimet e ndërmarra në shkollë për ato probleme, të cilat janë nuk janë kryer ose janë kryer pjesërisht.

PJESA E TRETË

MODELE TË PLOTËSIMIT TË FORMATIT TË VETËVLERËSIMIT TË SHKOLLËS

KËSHILLA PRAKTIKE

1. Gjatë plotësimit të Formatit të Vetëvlerësimit duhet të jeni të kujdesshëm dhe sa më objektiv. Shkalla e këtij objektiviteti dhe e korrektesisë përbëjnë një bazë të shëndoshë për efektivitetin e vetëvlerësimit tuaj dhe të besueshmërisë së tij në sytë e inspektorëve. Këtij qëllimi i shërbejnë modelet e paraqitur në këtë pjesë.
2. **Në vetvete, plotësimi i formatit**, të paraqitur në pjesën e dytë të këtij Manuali, **nuk është vetëvlerësim**. Formatit i Vetëvlerësimit përfaqëson një vend, ku regjistrohen dhe përmbledhen gjetjet e procesit të plotë të vetëvlerësimit. Megjithatë, nëse procesi i plotësimit të tyre përfaqëson një reflektim të ndershëm të shkollës, ai shërben si bazë e shkëlqyer për drejtuesit, mësuesit dhe të interesuarit e tjerë për përmirësimin e shkollës. Praktikisht, nëse arrin të jetë një reflektim i fuqishëm dhe profesional i gjendjes së shkollës, ai do të jetë pjesë edhe e vetë raportit të inspektimit.
3. Inspektorët e përdorin Formatin e Vetëvlerësimit gjatë procesit të inspektimit që ushtrohet në shkollën tuaj. Përmbledhja e vetëvlerësimit të shkollës (e pasqyruar në Formatin e Vetëvlerësimit), raportet e inspektimit të mëparshëm, si dhe rezultatet e shkollës shërbejnë si pikënisje e diskutimit midis inspektorëve dhe shkollës, në çastin kur inspektorët vijnë në shkollë dhe planifikojnë problemet që do të inspektohen. Prandaj, shkolla duhet të jetë e kujdesshme në plotësimin e Formatit të Vetëvlerësimit. Për më tepër, inspektorët kanë marrë të dhëna paraprakisht për kontekstin e shkollës (shih *Manuali Inspektimi i Plotë i Shkollës*). Nuk duhet harruar edhe se Formatit i Vetëvlerësimit ofron të dhëna të rëndësishme për cilësinë e menaxhimit dhe kapacitetin e shkollës për t'u përmirësuar.
4. Gjatë inspektimit, inspektorët synojnë të përcaktojnë sesa mirë i njih stafin drejtues pikat e forta dhe fushat që kanë nevojë për përmirësim të shërbimit arsimor që ofron shkolla juaj. Ndërkaq, *inspektorët presin që shkolla të jetë përqëndruar në ato përvoja, që provojnë konkluzionet e shprehura në Formatin e Vetëvlerësimit.*
5. Jini të thjeshtë dhe shmangni zhargonin. Përpiquni të jeni të kujdesshëm, të qartë dhe të ndershëm. Inspektorët presin që shkollat ta aktualizojnë Formatin e Vetëvlerësimit në të njëjtën linjë me ciklet e përmirësimit të shkollës.

Kujdes!

**Ky nuk është një proces burokratik që të ha kohë!
Në fakt, ai është proces krijues.**

6. Përgjigjuni rubrikave me anë të mendimeve të qarta dhe gjithmonë kujdesuni të justifikoni përgjigjet me një përshkrim të shkurtër të fakteve. Pohimi nuk mjafton. P.sh. referohuni shkurt

te rezultatet e provimeve dhe të testeve, por mos harroni të thoni se çfarë ju tregojnë këto rezultate, për çfarë ju kanë nxitur, si dhe influencën që kanë pasur në punën tuaj. Po kështu, referohuni edhe tek të dhëna të tjera që ju duken të arsyeshme, por me masë dhe duke shmangur hollësitë përshkruese.

7. Kujdesuni të komentoni jo vetëm atë që ka bërë shkolla për të nxitur rezultate të larta, por edhe ndikimin që ka pasur ajo te nxënësit. P. sh., shkolla duhet të komentojë ndryshimet që kanë ndodhur në grupe të veçanta nxënësish, jo vetëm në frekuentimin dhe qëndrimin e tyre në shkollë, por edhe në ato probleme që kanë lidhje me progresin e tyre.
8. Pasi plotësohet, Format i Vetëvlerësimit duhet të diskutohet dhe të aprovohet nga bordi i shkollës. Ai duhet të jetë publik.
9. **Hartimi i konkluzioneve.** Shkollat duhet të paraqesin një konkluzion të përmbledhur, i cili duhet të jetë i vlerësuar në një nga katër nivelet (Shih Manuali Inspektimi i Plotë i Shkollës).
10. Duhet të formuloni mendimin përmbledhës përfundimtar, të vlerësuar në nivelin përkatës. P. sh., në seksionin e arritjeve dhe standardeve, vlerësimi duhet të pasqyrojë standardet e arritura prej tyre dhe progresin e bërë me kalimin e kohës.

Kujdes!

Në këtë rast, element kyç është progresi i bërë nga nxënësit, jo rezultatet e çastit!

11. Në seksionin e efektivitetit të përgjithshëm, vlerësimi është një përmbledhje e të gjitha mendimeve kryesore. Në këtë rast, drejtuesit e shkollës duhet të kenë parasysh lidhjen e ngushtë midis progresit të nxënësve, cilësisë së mësimdhënies/të nxënësve dhe efektivitetit të menaxhimit të shkollës. Ky i fundit vlerësohet në kontekstin e rezultateve të nxënësve.
12. Nëse përfundimet e shkollës ndryshojnë nga ato të inspektorëve, këta mund të nxjerrin konkluzione rreth cilësisë së menaxhimit nëse gjejnë p. sh. se opinionet e stafit drejtues për rezultatet e shkollës janë të ndershme.
13. Më poshtë janë paraqitur disa modele të plotësimit të Formatit të Vetëvlerësimit, të cilat duhen lexuar në mënyrë kritike.

MODELE TË FORMATIT TË VETËVLERËSIMIT

Seksioni 1: KARAKTERISTIKAT E SHKOLLËS

Në këtë seksion, shkolla duhet të analizojë faktorët e kontekstit, të cilët duhen pasur parasysh në përcaktimin e prioritetëve për zhvillim. Shkolla duhet të jetë e kujdesshme në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me karakteristikat kryesore të nxënësve ose çështje të tjera, të cilat ndikojnë në rezultatet e saj. Po kështu, ajo duhet të jetë shumë e vëmendshme edhe me objektivat kryesore të planit të saj të punës. Më poshtë janë paraqitur modele të trajtimit të:

- Karakteristikave kryesore të shkollës, përfshi edhe klimën e saj;
- Kontekstit në të cilin punon shkolla;
- Çështjeve specifike për shkollën.

Në këtë pjesë të plotësimit të Formatit të Vetëvlerësimit, shkolla duhet të jetë shumë e qartë në informacionin që do të paraqesë për sfondin social-ekonomik të vet. Veç faktit që ky informacion përdoret më tej në Formatin e Vetëvlerësimit, ai i paralajmëron lexuesit, përfshi edhe inspektorët, për kontekstin e shkollës dhe sfidat me të cilat përballet ajo.

Model: Për shkollën 9-vjeçare

- *Shkolla i shërben komunitetit të lagjes X, qyteti Berat, Qarku Berat.*
- *Arritjet e shkollës në gjubën shqipe, lexim letrar dhe matematikë janë nën mesataren e qarkut (sipas të dhënave nga provimet e lirisimit dhe testimet e organizuara nga sektorët e trajnim/këshillimit)*
- *Niveli i pajisjeve shkollore është mbi nivelin e qarkut dhe atë kombëtar.*
- *Numri i nxënësve të ardhur nga zona të tjera është rritur dukshëm vitet e fundit. Aktualisht, ky numër përbën një të tretën e të gjithë nxënësve të shkollës. Numri i nxënësve romë, minoritarë nuk ka ndryshuar.*
- *Nuk ka dallime të dukshme lidhur me njohuritë e këtyre nxënësve në fillim të vitit shkollor. Niveli i tyre thuajse është i njëjtë, aq më tepër që ata përfaqësojnë familje me status social-ekonomik të ngjashëm.*
- *Lëvizjet e nxënësve janë të shumta, për shkak të migrimit. Specifik për shkollën është fakti që ajo ka mjedise cilësore dhe një bazë materiale- mësimore të plotësuar. Në këto kushte, shkolla parashikon të ketë progres të dukshëm drejt pjesëmarrjes në olimpiadat lokale/kombëtare dhe në veprimtaritë kulturore e sportive.*

Seksioni 2: MENDIMET E NXËNËSVE, PRINDËRVE DHE TË INTERESUARVE TË TJERË

Seksioni 2 përshkruan shkurt rrugët që përdor shkolla për grumbullimin e mendimeve të aktorëve kryesorë të saj. Seksioni kërkon që shkolla t'u përgjigjet **tri pyetjeve, duke shpjeguar:**

1. Si dhe sa shpesh shkolla grumbullon mendimet e tyre;
2. Cilat janë këto mendime;
3. Cilat janë masat që ka marrë shkolla në përgjigje të këtyre mendimeve.

Duhet pasur parasysh se shkollat nuk ngjajnë me njëra-tjetrën. Kështu që, secila shkollë raporton atë që bën dhe atë që thonë prindërit. Kjo është e mundur, sepse çdo shkollë ka burimet e veta, nëpërmjet të cilëve mëson mendimet e prindërve për shërbimin që ajo është duke ofruar.

Më poshtë është paraqitur një model nga Formati i Vetëvlerësimit të një shkolle.

Model: *Shkolla ka lidhje vërtet konstruktive me prindërit. Si lidhje kryesore shërbejnë pyetësorët e prindërve. Duke u plotësuar dy herë në vit, prej tyre rezulton se prindërit janë të kënaqur me shkollën. Këto mendime janë pasqyruar edhe në planin e shkollës. Pyetësi i rradhës është parashikuar të plotësohet në fund të semestrit të parë të vitit shkollor 2007-2008. Po kështu, realizojmë kontakte të rregullta nëpërmjet komunikimeve ditore me anë të nxënësve, takimeve të rregullta me prindërit dhe kontakte të tjera personale.*

Mendimet e nxënësve mblidhen nëpërmjet:

- *Qeverisë së nxënësve, për aktivitetet e së cilës shkolla ka parashikuar mjedisin dhe kohën e nevojshme;*
- *Pyetësorëve të nxënësve për mësimdhënien/ të nxënësve, intervistat etj., të cilat përdoren si pjesë e proceseve të analizës së shkollës.*

Shkolla jonë njihet me pikëpamjet e komunitetit më të gjerë nëpërmjet disa rrugëve. P. sh.,

- *Një nga mësuesit tanë është anëtar i këshillit bashkëpunues, i cili është përgjegjës për strategjinë e zhvillimit të qytetit tonë;*
- *Shkolla jonë është përfshirë në projektin e Bankës Botërore "Cilësi dhe barazi për të gjithë".*
- *Ne bashkëpunojmë ngushtë me DAR.*

Me mendimet e prindërve kemi vepruar në këtë mënyrë:

- *Kemi rishtuar procedurat e ndarjes së nxënësve në klasa;*
 - *Kemi organizuar kurse për përdorimin e kompjuterave të shkollës jashtë kohës së mësimi;*
 - *Disa prindër intelektualë janë ftuar të konsultojnë nxënësit në matematikë, biologji etj.*
 - *Kemi organizuar konsultime për disa klasa që kanë pasur probleme me realizimin e programit mësimor.*
 - *Kemi filluar një fushatë për shfaqjen e formave të ndryshme të traumës që mund të lindin si pasojë e mungesës së respektit reciprok midis nxënësve dhe mësuesve.*
-

Koment:

Ky model tregon se si ka reflektuar shkolla ndaj shqetësimeve të prindërve. Natyrisht, modeli i mësipërm nuk pasqyron shqetësimet e nxënësve dhe të interesuarve të tjerë. Nga ana tjetër, jo të gjitha shkollat kanë kaq shumë veprimtari në këtë fushë. Prandaj, disa prej tyre mund të deklarojnë ndershmërisht, se nuk u janë përgjigjur shqetësimeve të prindërve për arsye të ndryshme.

Kujdes!

Ajo që ka rëndësi është shpjegimi i qartë i situatës, jo fshehja e saj!

Seksioni 3: REZULTATET DHE STANDARDET E NXËNËSVE

Cili është kuptimi i arritjeve dhe standardeve?

Arritjet: Matin njohuritë e nxënësve, shkallën e të kuptuarit dhe shprehitë që kanë fituar. Ato tregojnë shkallën e nxitjes së nxënësve për të mësuar dhe nëse janë duke punuar me kapacitetin e tyre të plotë intelektual. Themelore këtu është ajo që shton shkolla në formimin e tyre dhe nëse nxënësit mësojnë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Standardet: Nënkuptohe nivelin e njohurive, i të kuptuarit dhe i shprehive që arrijnë nxënësit, krahasuar me nxënësit e së njëjtës moshë në shkallë kombëtare. Në CL të shkollës 9-vjeçare dhe në shkollën e mesme, standardet është mirë të shprehen me termat e notave në testime dhe provime; në CF rekomandohet shprehja e tyre nëpërmjet formimit të nxënësve në lidhje me objektivat fillestare.

Për të ofruar një tablo të plotë, mendimet duhet të fokusohen në vitin e fundit shkollor, për të cilin shkolla zotëron të dhëna të besueshme. Nëse shkolla mendon se disa të dhëna janë të gabuara ose mund të ofrojnë përfundime të gabuara, ajo duhet ta deklarojë këtë fakt, të shpjegojë arsyen dhe të paraqesë mendimet e saj për korrigjimin e tablosë me të dhënat të nevojshme.

Në këtë seksion janë të nevojshme edhe mendimet për progresin dhe standardet e arritura nga grupe të ndryshme nxënësish, gjë që kërkon shpjegim.

Ndërkaq, krahas mendimeve për performancën e përgjithshme të shkollës, është esenciale të jepen mendime të shkurtëra për standardet në të gjitha lëndët mësimore.

Model:

- Standardet në lëndët kryesore janë mbi mesataren e vendit (Raporti i AVA);
- Ka progres të dukshëm në gjuhën shqipe dhe në matematikë (Raporti i AVA, të dhëna të shkollës);
- Standardet në lëndët e tjerë mësimore në përgjithësi janë shumë të mira (Raporti analizës vjetore të shkollës. (Raporti i analizës vjetore të DAR/ZA). Ka arritje në gjuhën angleze. Megjithatë, ka dobësi në Dituri Natyre, Muzikë, Vizatim (të dhëna të shkollës);
- Përqindje e lartë e kalueshmërisë së klasave (të dhëna të shkollës);

- Numër i madh lëndësh mësimore që kanë pasur rritje të dukshme, megjithëse ka disa dobësi në histori, biologji (analizë e këshillit pedagogjik);
- Në përgjithësi, nxënësit mësojnë mirë dhe në përputhje me objektivat e vendosur; nuk ka dallime të dukshme në performancën e grupeve të ndryshme të nxënësve (Të dhëna të shkollës).

Progresi i nxënësve

Përgjithësisht, nxënësit bëjnë progres shumë të mirë në shkollë. Megjithatë, ne sapo kemi filluar të vlerësojmë progresin e nxënësve nga klasa në klasë në CF. Kjo ka të bëjë me progresin e bërë lidhur me objektivat tanë, sidomos në matematikë. Të dhënat konfirmojnë se kemi progres shumë të mirë, me përjashtim të matematikës dhe të disa lëndëve mësimore të përmendura më sipër. Kjo është një fushë ku planifikojmë ndryshime, gjë që është pasqyruar në planin tonë të punës. Në përgjithësi, përfundimet e nxënësve, krahasuar me objektivat, janë shumë të mira, duke theksuar se ne i monitorojmë ato nga afër. Në fakt, shkolla kryen vlerësimin e atyre fushave, të cilat ndjehet nevoja për më mirë:

Fushat për përmirësim

Të gjitha lëndët kanë vend për përmirësim, gjë që e bëjmë vazhdimisht duke kërkuar rrugë, duke analizuar dhe duke vendosur objektiva nxitëse. Ndryshimet në strukturën kurrikulare, futja e teksteve alternative, kërkimet në fushën e metodave të mësimdhënies dhe përdorimi i të dhënave nga vlerësimet e organizuara në shkollë kanë sjellë përmirësime të dukshme në matematikë në klasën e 3-të (shiko më poshtë).

Në këtë klasë, megjithëse nga një tendencë në rritje në rezultate, nxënësit, në përgjithësi, kanë rezultate të pakënaqshme. Gjë që është e dukshme në rreth 25% të nxënësve, të cilët nuk kanë progres të dukshëm. Kemi organizuar konsultime dhe kemi rishikuar metodat e mësimdhënies, duke përdorur më mirë të dhënat e vlerësimeve, duke vendosur objektiva më të saktë dhe duke bërë punë më të diferencuar. Në këtë mënyrë, matematikës dhe lëndëve ku kemi probleme, u kemi dhënë një status më formal brenda kurrikulës, duke garantuar një përvojë të qëndrueshme për nxënësit dhe mësuesit. Gjë që po ndihmon mësimdhënien/ të nxënësit dhe po sjell progres. Aktualisht, ky është një nga objektivat tanë.

Kujdes! Edhe këtu shkolla duhet të jetë shumë e sinqertë!

Viti 6 Edukatë shoqërore – tendencë e dukshme e rënies së rezultateve, që ka lidhje me probleme të stafit mësimor të shkollës (i është raportuar DAR/ZA-së).

Viti 7 Histori – rënie në rezultate; ndjehet nevoja e përmirësimit të mësimdhënies, në shërbim të përfshirjes së nxënësve në mësim dhe rritjes së standardeve (Raporti i inspektimit).

Viti 8 Fizikë – Aktualisht, po zbatohet kurrikula e re. Kështu që jemi duke e planifikuar me kujdes, për të siguruar një vlerësim më të rregullt, nëpërmjet zërbërimit të detajuar të objektivave në shërbim të standardeve. Kobët e fundit kemi realizuar një vlerësim të përgjithshëm të këtyre problemeve, duke përdorur shkallën me katër nivele të vlerësimit, të ngjashme me atë të inspektimit.

Këshillë:

Mund të vazhdoni në këtë mënyrë me probleme në lëndë të tjera mësimore.

Vlerësim përmbledhës i përgjithshëm për rezultatet dhe standardet e nxënësve.

Përveç fushave të mësipërme, të cilat kanë nevojë për përmirësim, dubet të pranojmë se arrijtjet e nxënësve tanë janë dukshëm mbi mesataren dhe janë veçanërisht të dukshme në gjuhë, lexim, ku rezultatet e kanë vendosur shkollën tonë në 5% e shkollave më të mira të vendit.

Në përgjithësi, nxënësit tanë kanë progres shumë të mirë gjatë kohës së shkollës dhe arrijnë standarde më të larta se ato të parashikuara. Gjë që ndodh pavarësisht nga mjedisi shoqëror dhe aftësitë e tyre.

Konkluzion:

Ky vetëvlerësim tregon se shkolla i kushton të njëjtën vëmendje si standardeve, ashtu edhe progresit të nxënësve. Por, çdo shkollë është unike. Prandaj, në varësi të specifikave të tyre, disa shkolla mund t'i kushtojnë vëmendje progresit, shkolla të tjera standardeve.

Kujdes!

Për këtë vlerësim, shkolla duhet të marrë parasysh standardet e arritura nga nxënësit, krahasuar me mesataren e vendit dhe me shkollat e ngjashme. E njëta gjë vlen edhe për progresin.

Seksioni 4: KUJDESI PËR NXËNËSIT

Të dhënat për frekuentimin dhe largimet e lejojnë shkollën të vlerësojë efektin e çdo veprimi të ndërmarrë për përmirësimin e zhvillimit personal të nxënësve, të arritjeve dhe të progresit të tyre.

Gjatë plotësimit të këtij seksioni, konkluzionet duhet të jenë të prera dhe të kujdeshme, sepse kontributi i shkollës në zhvillimin personal të nxënësve është thelbësor. Rekomandohet që konkluzionet të mbështeten në fushën “Kujdesi për nxënësit” të *Manualit të Inspektimit*. Sigurisht, suksesi i shkollës në këtë fushë do të vlerësohet në bazë të cilësisë së formimit të nxënësve.

Model: Shkolla 9-vjeçare

Ky seksion është pjesë e vetëvlerësimit të shkollës.

Zhvillimi shpirtëror i nxënësve është i mirë. Mësuesit e lëndëve i monitorojnë me kujdes këto zhvillime, sipas kriterëve dhe të dhënave të qarta. Rezulton, se shumica e nxënësve pëson rritje, në këndvështrimin e të kuptuarit të vetvetes dhe të shokëve gjatë kohës në shkollë. Për rrjedhojë, ata besojnë gjithmonë e më shumë te vehtëja, si dhe kanë dëshirë të eksplorojnë e të marrin rrisht.

Nxënësit kanë rritje në të kuptuarit e të bukurës, dashurisë, drejtësisë dhe urrejtjes. Ata mbajnë qëndrime ndaj problemeve që kanë lidhje me konfliktin, përgjegjësitë shoqërore dhe përgjegjësitë ndaj mjedisit. Për rrjedhojë, nxënësit tregojnë nivel të lartë dhembshurie dhe, shpesh, zemërim ndaj padrejtësisë. Në këtë kontekst, ne punojmë për t'i mbështetur në procesin e eksplorimit të bindjeve të tyre dhe i kemi të dhënat e duhura për këtë qëllim.

Zhvillimi moral është i mirë për shumicën e nxënësve. Diskutimet tona me nxënësit dhe të dhëna të tjera që kemi rreth sjelljes, qëndrimeve dhe përgatitjes së tyre tregojnë, se shumica dërrmuese ka një formim të fortë moral, bazuar në punën e shkollës. Kjo është shfaqur

në diskutimet e rregullta që shoqërojnë mësimet e shkencave shoqërore (edukata), ku nxënësit inkurajohen të debatojnë rreth problemeve morale.

Ne përpiqemi të kemi një kod moral të fortë, të bazuar në respektin për të gjithë. Pyetëtori i analizuar pak kohë më parë tregon, se thujse të gjithë nxënësit e ndjejnë këtë kod moral dhe kanë dëshirë ta respektojnë, për t'u ndjerë të sigurtë. Për fat të keq, ndonjëherë standardet e komunitetit lokal i kundërvihen standardeve që kanë fituar nxënësit, sapo ata e mbarojnë shkollën. Për këtë fakt kemi të dhëna të mjaftueshme.

Kemi mendimin se mund të punojmë më mirë. Planifikojmë të monitorojmë zhvillimin personal të nxënësve më nga afër, sepse jemi më të vetëdijshëm për nevojat e nxënësve, si dhe për rrugët e duhura për plotësimin e tyre. Siç u përmend më sipër, kryesisht për shkak të rrethanave familjare të disa fëmijëve, ka një grup nxënësish, të cilët kanë vështirësi mësimore dhe personale. Gjë që duket në performancën, sjelljen dhe frekuentimin e shkollës nga ana e tyre. Kemi strategjitë e duhura për këto probleme, por kemi bindjen se me fokusin kryesor të zhvillimit personal do të kemi më shumë rezultate. Praktikisht, kjo është një nga pikat e planit tonë të punës. Ndërkaq, vëmendje të veçantë kemi filluar t'i kushtojmë shfaqjeve të traumës psikike në shkollë. Ka shumë ngjarje të vogla, të cilat tregojnë se ka ardhur koha të vendosim objektiva të qarta, sigurisht me ndihmën e punonjësit social dhe institucioneve të specializuara në fushë.

Siç shihet, ky konkluzion është interesant dhe i besueshëm, sidomos nga që në të përfshihet një strategji efektive e trajtimit të problemit, pra një menaxhim efektiv.

Model nga një shkollë me probleme në frekuentim

Frekuentimi ka qenë një nga problemet kryesore të punës sonë. Kështu, gjatë 4 viteve të fundit, frekuentimi i nxënësve është rritur nga 88% në 91%. Kjo rritje është rezultat i fokusimit të punës së shkollës në rëndësinë që ka frekuentimi i nxënësve. Masat që kemi marrë janë: monitorimi dhe vlerësimi i të dhënave të frekuentimit për të gjithë nxënësit para fillimit të mësimit; komunikimi i mungesave gjatë mësimit me nxënësit, prindërit dhe stafin e mësuesve. Në këtë mënyrë, synojmë që në shtator të vitit 2008 në shkollë të vijnë 95% e nxënësve. Gjë që do të shoqërohet edhe me një punë më të kujdesshme për rritjen e rezultateve të nxënësve.

Sjellja dhe qëndrimet e nxënësve ndaj mësimin janë në fokus të vazhdueshëm. Masat që kemi marrë përfshijnë: vendosjen e një kodi të sjelljes, rishikimin e misionit tonë, grupimin e mendimeve të nxënësve, të mbledhura me anë të qeverisë së nxënësve, vëzhgimeve etj. Në përgjithësi, nxënësit sillen mirë dhe qëndrimi i tyre ndaj mësimin vjen duke u përmirësuar. Ka një problem të vazhdueshëm me nxënësit romë, ndaj të cilëve metodat tona nuk kanë funksionuar. Kështu që, jemi duke përpunuar strategji më të gjera, të cilat synojnë t'i mbështetnin në procesin e të nxënësve, konsultimeve, programeve alternative, vizitave në shtëpi etj. Si rrjedhojë, numri i nxënësve romë që frekuentojnë shkollën është rritur nga 8 në 15. Objektivi ynë në këtë fushë është që jashtë sistemit arsimor të mos ketë më shumë se 8 nxënës romë.

Seksioni 5: CILËSIA E MËSIMDHËNIES/TË NXËNIT

Mendimet rreth cilësisë së mësimdhënies janë të lidhura me cilësinë e të nxënit dhe duhet të mbështeten në të dhëna të besueshme. P.sh., shkolla duhet të trajtojë standardet dhe progresin e bërë nga nxënësit; por, ajo duhet të bëjë vlerësime rreth shkallës së efektit që ato kanë mbi cilësinë e mësimdhënies. Që të vlerësojnë mësimdhënien, shkollat duhet të kenë një kuptim shumë të qartë të cilësisë së saj. Veçanërisht, vlerësuesit duhet të dinë të shpjegojnë se sa mësimdhënia plotëson nevojat e nxënësve. Ata duhet t'i përgjigjen pyetjes: “Nga e dimë që cilësia është e mirë?”

Model

Cilësia e mësimdhënies/të nxënit është e mirë. Këtë e dimë, sepse rezultatet e një sërë aktiviteteve të monitoruara, përfshi edhe vëzhgimin e mësimeve dhe regjistrimin e rezultateve të nxënësve, tregojnë se të gjithë nxënësit janë duke bërë progres të mirë.

Sukseset e mësimdhënies përfshijnë:

- Përvehtësim i mirë i dijeve dhe njohurive në lëndët mësimore bazë;
- Planifikim i detajuar i mësimin, gjë që u krijon mundësi nxënësve për të shfaqur inisiativë, të jenë të pavarur, të mendojnë për vetveten dhe të shprehin ide me besim.
- Vlerësime të kujdesshme të përvehtësimit të mësimeve nga nxënësit. Mësuesit bëjnë vlerësime të qarta, të cilat u lejojnë të plotësojnë nevojat e individëve dhe t'i përfshijnë në veprimtari individuale ose në grup.
- Plane specifike dhe efektive për plotësimin e nevojave të grupeve të veçanta të nxënësve, përfshi nxënësit me probleme nga më të ndryshme.
- Bashkëveprim me cilësi të lartë me nxënësit.
- Mbështetja e nxënësve, duke i ndihmuar të marrin pjesë në diskutime dhe duke u dhënë kohë për të menduar para se të përgjigjen.
- Përdorimi i gjuhës amtare, për të krijuar besim dhe kompetencë në të shprehur, si dhe për përmirësimin e përvehtësimit të gjuhës shqipe nga nxënësit.
- Përdorim efektiv i mundësive kroskurrikulare, në shërbim të përvehtësimit të njohurive dhe konsolidimit të shprehive.
- Fakti që i gjithë stafi përdor modele të mira, duke treguar respekt për nxënësit, në mënyrë që ata të ndjehen të qetë dhe të sigurtë.
- Menaxhim i vazhdueshëm i sjelljes, i cili gjeneron një klimë mësimore të qëndrueshme dhe të sigurtë.

Sa më sipër, konfirmohet nga stafi drejtues, shefat e departamenteve dhe vëzhgimet reciproke të mësuesve për të gjithë aspektet e mësimdhënies. Për këto kemi të dhëna të plota. Kemi ngritur një grup të përhershëm monitorues mësuesish, i cili bashkëvepron me stafin drejtues. Proceset tona të monitorimit dhe vlerësimit na ndihmojnë për t'u siguruar se mësimdhënia është e mirë dhe plotëson nevojat individuale të nxënësve. Po kështu, kemi bashkëpunim të ngushtë me sektorin e trajnimit në DAR/ZA dhe organizojmë monitorime të përbashkëta për moderimin e vlerësimeve tona. Këto monitorime i kemi të ruajtura në dosje.

Për të siguruar vazhdimësi në cilësinë e mësimdhënies kemi sisteme të qarta të punës me mësuesit e rinj dhe stafin ekzistues. Efekti i cilësisë së mirë të mësimdhënies shihet në progresin që janë duke bërë nxënësit tanë. Shkolla trajton me kujdes kurrikulën mësimore, duke siguruar kuptimin, planifikimin dhe realizimin e programit mësimor.

Ndaj nxënësve tregohet kujdes, duke i këshilluar dhe mbështetur.

- Cilësia e kujdesit tonë të përditshëm është shumë e mirë; nxënësit ndjehen shumë mirë dhe kanë progres shumë të mirë në zhvillimin e tyre personal, social, emocional dhe në shprehjet e komunikimit.
- Jemi të vëmendshëm dhe i përgjigjemi shumë mirë nevojave emocionale të nxënësve, nëpërmjet vëzhgimeve të orientuara dhe komunikimit të mirë me ta dhe prindërit e tyre.
- Bashkëveprimë shumë mirë me punonjësin social, mjekun e shkollës, dentistin etj.
- Procedurat tona të regjistrimit përfshijnë vizita në familjet e nxënësve, veprime të shpejta dhe sistemim e nxënësve nëpër klasa, duke respektuar dëshirën e tyre. Ata orientohen shpejt në shkollë.
- Mbajmë lidhje të ngushta me shkollat nga vijnë/shkojnë nxënësit tanë, për t'i ndihmuar të përshtaten sa më shpejt me shkollën.

Seksioni 6: CILËSIA E MENAXHIMIT DHE E ADMINISTRIMIT TË SHKOLLËS

Shpesh, ky është seksioni më i vështirë për t'u vlerësuar nga drejtuesit e shkollës. Kështu që, rekomandohet asistencë nga jashtë shkollës, p.sh., nga sektorët e trajnimit të DAR/ZA ose agjensi që punojnë në fushën e arsimit. Drejtuesit e shkollave duhet të jenë të bindur se vlerësimi i menaxhimit nëpërmjet rezultateve ofron një pikë nisëse shumë të dobishme për vetëvlerësim. Në këtë rast, vlerësimet duhet të përputhen me vlerësimet e tjera në seksionet e ndryshme të Formatit të Vetëvlerësimit. Nëse në shkollë gjithëçka ecën shumë mirë, atëherë janë të gjitha shanset që menaxhimi i të gjitha niveleve të jetë shumë i mirë. Por, është e vërtetë edhe e kundërta. P.sh., nëse është vështirë të vlerësohet se si e ndan përgjegjësinë stafi drejtues i shkollës, atëherë kjo do të reflektohet në vlerësimet për performancën e tyre të përgjithshme.

Në këtë seksion kërkohen disa vlerësime për probleme të forta, të mbështetura në të dhëna të besueshme. P.sh., Si e njeh ekipi drejtues që të gjithë nxënësit kanë mundësi të barabarta dhe është shmangur diskriminimi? Çfarë monitorimi është bërë dhe si janë shmangur ose adresuar problemet që janë shfaqur? Si janë zgjidhur problemet e stafit mësimor dhe si është cilësia e lidhjeve me DAR/ZA? A mjafton të thuhet se DAR/ZA janë të mira dhe na mbështesin në përpjekjet tona? Vlerësimet e këtyre pyetjeve duhet të jenë qartësisht të mbështetura.

Së fundi, nuk është e domosdoshme që menaxhimi të jetë i të njëjtës cilësi, gjë që shihet edhe në faktin që shumë drejtues shkollash janë të mirë në këtë apo atë drejtim. P.sh., një drejtues mund të jetë frymëzues, por mbështetet shumë tek zëvendës drejtorët për rolet dhe vendimet delikate.

Shembulli që vijon vjen nga një shkollë me 100 nxënës, të cilët kanë vështirësi të mëdha në të mësuar. Është paraqitur vetëm pjesa që ka të bëjë me menaxhimin e saj.

Sa efektive është drejtorja e shkollës në vendosjen e drejtimeve të qarta të punës drejtuese për të përmirësuar dhe nxitur cilësi të lartë në kujdesin për fëmijët, mësim dhe kualifikimin e mësuesve?

Sektori i trajnimit ka konfirmuar se menaxhimi i shkollës në tre vitet e fundit është shumë i mirë për shkak të efektit që ka sjellë në rritjen e standardeve dhe lëvizjen e shkollës në drejtim pozitiv. Edhe inspektimi i fundit e vlerësoi shumë të mirë punën e drejtorit të shkollës.

Shkolla ka një vizion të qartë për nxënësit e saj, për standarde të larta dhe për procesin mësimor. Ky mesazh përfshin të gjithë elementët e punës së shkollës. Vizioni është zbrëthyer qartë në planin e zhvillimit të shkollës. Synimet dhe prioritetet janë të qarta. Analiza vjetore e tyre nga i gjithë stafi siguron vëmendje të vazhdueshme në proceset brenda shkollës. Prindërit përfshihen rregullisht në hartimin e planit, por dy vitet e fundit nuk kanë sugjeruar ndonjë ndryshim. Stafi ka kryer një punë shumë të mirë në procesin e vetëvlerësimit dhe në rritjen e standardeve.

Koment:

Këtu ka shumë deklaratime, të cilat mund të konsiderohen si mbrojtje. Sidoqoftë, ka shumë detaje dhe shpjegime, të cilat e bëjnë vlerësimin bindës dhe të besueshëm.

Plani i Zhvillimit të shkollës është hartuar me kujdes, gjë që shihet në vizionin dhe objektivat e saj. Dallohen dy elementa: i pari është strategjik dhe afatgjatë, i dyti përfaqëson planin vjetor. Të dy elementat janë lidhur me një planifikim të kujdesshëm të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare të shkollës. Meqë shkolla pritet të inspektohet, elementi strategjik i planit të saj do të rishqyrtohet për të pasqyruar rekomandimet e inspektimit. Në përputhje me kërkesat e Formatit të Vetëvlerësimit, shkolla ka hartuar një konkluzion të përgjithshëm.

Konkluzion i përgjithshëm

Ka disa probleme që duhen përmirësuar. Ne duhet të:

- Fillojmë të përmirësojmë efektin e mungesës së buxhetit për mirëmbajtjen e godinës së shkollës, të klasës së kompjuterve dhe të bazës materiale mësimore;
- Vazhdojmë të rrisim rolin e mësuesve në sfidën tonë për një shkollë të përgjegjshme për cilësinë e shërbimit që ofron;
- Vazhdojmë përmirësime në shërbimin që u ofrojmë nxënësve me probleme të shëndetit mendor;
- Fillojmë të trajtojmë problemin e traumës në shkollë.
- Vazhdojmë të përmirësojmë bashkëpunimin me sektorin e trajnimit.

Por, pavarësisht nga sa më sipër, menaxhimi i shkollës është shumë i mirë. Vizioni i saj është i qartë, i kuptuar nga të gjithë dhe ofron mundësi për njohjen e veprimtarisë së përditshme dhe planifikimin për të ardhmen. Stafi drejtues ka objektiva të larta për vetveten. Arritjet e secilit shpërblehen, kurse dobësitë trajtohen bashkërisht, por pa kompromis.

Kujdes!

Këtu ka diçka, e cila mund të eksplorohe nga inspektorët për të testuar vlerësimet tuaja.

Megjithëse shkolla nuk është rikonstruktuar dhe ka probleme për sistemimin e nxënësve në klasa, ajo ka punuar me imagjinatë duke realizuar më të mirën e mundëshme. Në këtë mënyrë, shumica e nxënësve ka plotësuar më së miri objektivat e shkollës.

Koment:

Shkolla e ka vlerësuar veten e saj. Është e vështirë të mos pajtohesh me këtë vlerësim, po të kemi parasysh të dhënat e ofruara në Formatin e Vetëvlerësimit. Pra, inspektorët do ta përdorin Formatin tuaj të Vetëvlerësimit për zgjedhjen e të dhënave, të nevojshme për procesin e inspektimit dhe për të parë nëse vlerësimet tuaja janë të sakta.

Seksioni 7: EFEKTIVITETI DHE EFICIENCA E PËRGJITHSHME

Në seksionin e fundit të Formatit të Vetëvlerësimit bashkohen të gjithë vlerësimet e mëparshme. Ky seksion trajton tre çështje kryesore:

- Efektivitetin e përgjithshëm të procesit mësimor, duke përfshirë sukseset dhe pikat e dobta.
- Efektivitetin e çdo hapi të ndërmarrë për përmirësim, qysh nga inspektimi i fundit;
- Kapacitetin e shkollës për përmirësim të mëtejshëm.

Vlerësimet dhe të dhënat mbështetëse duhet të jenë në përputhje me të gjitha vlerësimet e dhëna *kudo* në këtë Format. Po kështu, është shumë e rëndësishme të jeni shumë të hapur rreth përmirësimeve që ka bërë shkolla qysh nga inspektimi i fundit, rreth asaj se çfarë duhet bërë dhe aspekteve të tjera të punës së shkollës.

Model, i fokusuar në vlerësimin e standardeve mësimore dhe të mësimdhënies.

Efektiviteti i përgjithshëm i shkollës është shumë i mirë. Përmirësimi i kryer qysh nga inspektimi i fundit dhe kapaciteti për përmirësim të mëtejshëm janë shumë të mirë. Gjatë vlerësimit të mësipërm janë identifikuar këto pika të forta:

- Ka nivel të lartë të arritjeve në të gjithë spektrin e kurrikulës shkollore nga të gjithë nxënësit e grupeve të ndryshme;
- Zhvillimi personal i nxënësve është shumë i mirë;
- Ka menaxhim efektiv, i cili nxit pritje të larta dhe kërkesë të vazhdueshme për përmirësim dhe novacion;
- Baza materiale mësimore mbështet mësimnxënien dhe zhvillimin e nxënësve;
- Marrëdhënie shumë të mira mësues-nxënës, të cilat krijojnë një mjedis mbështetës të nxëni;
- Sistem kujdesi, që mbështet kapërcimin e pengesave në të mësuar dhe nxit përfshirjen.

Çfarë është përmirësuar qysh nga inspektimi i fundit?

Në kuptimin e rezultateve mësimore për vitin mësimor 2006-2007, të krahasuar me vitin shkollor 2005-2006:

- Zotërojnë mbi 80% të programit mësimor:

Në klasën 4:

Gjuhë – Lexim:	70% nga 62%;
Matematikë:	72% nga 65%

Në klasën 5:

Gjuhë – Lexim:	31% nga 50%
Matematikë:	22% nga 11%

Në klasën 6:

Gjuhë – Lexim:	27% nga 30%
Matematikë:	2% nga 25%

Në klasën 7

Gjuhë – Lexim:	33% nga 58%
Matematikë:	32% nga 26%
Histori:	42% nga 50%

Në klasën 8:

Gjuhë – Lexim:	53% nga 38%
Matematikë:	25% nga 38%
Kimi:	35% nga 33%
Histori:	32% nga 86%

Zotërojnë 80% të programit mësimor:

Në gjuhën angleze: mesatarisht 35% e nxënësve,

Në biologjinë e klasës: 6-7 25% e nxënësve

Në gjeografinë e klasës 5-6 dhe 7, përkatësisht 63%, 31% dhe 43%.

Koment:

Kjo përfaqëson një përmbledhje me vlerë të efektivitetit të përgjithshëm të shkollës.

Çfarë duhet bërë për të siguruar përmirësim të mëtejshëm?

Në kuptimin e mësimdhënies/mësimnxënies:

- Kemi nevojë të përmirësojmë rezultatet në ato lëndë mësimore, të identifikuara me rezultate të ulta në lidhje me shkollat analoge/lëndët e tjera/parashikimet;
- Kemi nevojë të sigurojmë mbajtjen e cilësisë së mësimdhënies në nivel shumë të mirë, duke siguruar që çështjet e identifikuara në vëzhgimet e mësimëve të jenë të qarta, t'i shërbejnë performancës dhe t'i adresohen shprehive me cilësi të lartë të mësimdhënies;

- Jemi duke kërkuar fleksibilitet më të madh në vitin e fundit të shkollës,
- Synojmë të rritim përdorimin e mjedisit mësimor virtual për të përmirësuar aksesin në teknologjinë e informacionit. Në të njëjtën kohë, kemi filluar një aksion në lidhje me shfaqjen e traumës në shkollën tonë.

Nga pikëpamja e pajisjeve mësimore:

- Duhet të vazhdojmë të merremi me problemin e pabarazisë në sistemimin e nxënësve nëpër klasa, sidomos në laboratorin e fizikës dhe të kimisë;
- Duhet të rritim aksesin në teknologjinë e informacionit të nxënësve, stafit mësimor dhe atij administrativ.

Nga pikëpamja e menaxhimit dhe organizimit të shkollës:

- Do të punojmë me zëvendës drejtorët dhe shefat e departamenteve, duke u fokusuar në menaxhim më të mirë të departamenteve lëndore dhe në shtrirjen e vëzhgimeve të aktiviteteve mësimore dhe të vizitave reciproke;
- Kemi nevojë të monitorojmë, analizojmë dhe vlerësojmë mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave, për të siguruar analiza efektive të performancës së shkollës dhe zbatimin e planit të zhvillimit të saj.

Koment:

Në këtë vlerësim shihet qartë se çfarë duhet bërë për të përmirësuar më tej shkollën.

PJESA E KATËRT

KËSHILLA PRAKTIKE PËR PLOTËSIMIN E FORMATIT TË VETËVLERËSIMIT TË SHKOLLËS

PJESA A: VETËVLERËSIMI

Kujdes!

Formati i Vetëvlerësimit duhet të jetë një përmbledhje e vetvlerësimit të shkollës.

1. Karakteristikat e shkollës suaj

Cilat janë karakteristikat e shkollës suaj?

Gjatë plotësimit të seksionit B dhe C të këtij formati, bëni një përshkrim të shkurtër të veçorive të shkollës suaj.

(Kini parasysh: kjo është një mundësi për një përmbledhje të shkurtër të karakteristikave kryesore të shkollës dhe nuk është nevoja të vendosni tabela.)

1a Përshkruani karakteristikat kryesore të nxënësve, përfshi:

- Arritjet e tyre në fund të vitit shkollor dhe mënyra se i njihni ato;
- Sfondin e tyre social dhe ekonomik, ku të tregohet niveli ekonomik i familjeve të tyre.

Shënim: Kini parasysh, se jeni duke analizuar dhe vlerësuar, jo duke përshkruar. Për secilin pohim përmbledhës që bëni, paraqisni të dhënat ku jeni bazuar me kllapa në fund të pohimit. Kjo ju ndihmon të mos përsërisni të dhënat.

- *Cilat janë arritjet në fund të vitit shkollor?* (Duhet të komentoni rezultatet tuaja më të fundit. Po kështu, duhet të shikoni vlerësimet që keni bërë në shkollë. Krahas komentit të tablosë së përgjithshme, shikoni shpërndarjen e rezultateve brenda një viti shkollor, sepse shpërndarja në kohë e vlerësimeve të shpie drejt rezultateve reale të nxënësve. Në të njëjtën kohë, komentoni të metat dhe pikat e forta që kanë rezultuar nga vlerësimet brenda shkollës, sidomos dobësitë specifike në gjuhë shqipe e lexim, matematikë etj. Gjikimi juaj të jetë i mbështetur në të dhëna.
- *A ka ndryshime të dukshme midis viteve?* Cilat janë rezultatet e nxënësve në provimet e liritimit/Maturës Shtetërore? A ka diferenca të dukshme midis vlerësimeve të shkollës dhe vlerësimeve në këto provime? *A ka ndryshuar profili i shkollës?* (Shënim: Nëse rezultatet midis viteve shkollore ndryshojnë, inspektorët kërkojnë të vlerësojnë se si ka qenë shërbimi arsimor i ofruar nga shkolla për secilin vit).

- *Cili ka qenë ndikimi i nxënësve të grupeve të ndryshme moshore, të cilët kanë ardhur në shkollë (nxënësit e klasës së parë, të pestë, të nëntë etj.? P.sh. a ka një numër të konsiderueshëm nxënësish që kanë probleme me frekuencimin? (Shikoni të dhënat e raportuara pranë ZA/DAR).*
- *Cili është sfondi social dhe ekonomik i nxënësve? (Shiko formatet e Manualit Inspektimi i Plotë i Shkollës, të cilët edhe mund të mos mjaftojnë për të dhënë një tablo të plotë. Shkolla mund të përdor të dhëna nga bashkia/komuna për të ardhurat e familjeve të nxënësve).*
- *Çfarë dini për familjet e nxënësve? Cilat janë perspektivat e zhvillimit lokal social dhe ekonomik? P.sh. mundësitë lokale të punësimit mund të kenë ndikim negativ, nëse janë të vogla.*
- *Cila është përqindja e nxënësve që mësojnë anglisht? Cila është përqindja e gjuhëve të tjera në shkollë? (Shiko Manualit Inspektimi i Plotë i Shkollës). Cila është perspektiva e gjuhëve të huaja në shkollë?*
- *Cilat janë rezultatet e nxënësve në gjuhën angleze dhe në gjuhët e tjera të huaja, që zhvillohen në shkollë? Cili është ndikimi i tyre në treguesit e përgjithshëm të shkollës?*
- *Cila është përbërja etnike në shkollë? (Shiko Manualit Inspektimi i Plotë i Shkollës)*
- *A ka probleme djem-vajza apo probleme në grupe të veçanta nxënësish të shkollës?*

Shënim: Mund të qëllojë që disa inspektorë të mos jenë të familjarizuar me karakteristikat e disa shkollave të DAR/ZA. Fjala është për probleme të tilla, si: transporti i mësuesve dhe i nxënësve, mungesa e mësuesve të diplomuar, gjendja fizike e shkollës etj., të cilat ndikojnë në të nxënët e nxënësve.

1b Paraqisni në mënyrë të përmbledhur synimet tuaja dhe përshkruani çdo karakteristikë të veçantë të shkollës suaj të tillë, si:

- Nëse synoni të bëheni një shkollë e profilizuar, me status të veçantë dhe, nëse jeni e tillë, ndryshimet që kanë ndodhur për shkak të këtij statusi;
- Nëse jeni një shkollë me karakter fetar;
- Elemente të veçantë të shkollës, shërbime komunitare që ofroni;
- Bashkëpunime me OJQ, projekte, institucione për çështje të tilla, si: kurrikula, kualifikimi etj.

- *A ka ndonjë synim për shkollën, përfshirë edhe atë që ka lidhje me statusin special të shkollës?*
- *Shkolla, ka apo planifikon një status special? Çfarë do të bëjë shkolla për këtë ndryshim? Cilat janë ndryshimet që kanë ndodhur për shkak të statusit special? Si kanë ndikuar këto ndryshime në klimën dhe identitetin e shkollës?*
- *A ka partnerë komunitarë/fetar?*
- *A janë pasqyruar synimet e shkollës në planin tuaj të punës?*

- *Cila është klima e komunitetit shkollor? A ka shkolla elemente speciale, shërbime komunitare? Cili është ndikimi i këtyre shërbimeve në rezultatet e shkollës?*
- *Në cilat bashkëpunime është përfshirë shkolla dhe cili është ndikimi i këtyre bashkëpunimeve?*
- *A ka bashkëpunime të veçanta me biznesin, grupet komunitare etj.?*

1c Paraqisni probleme specifike kontekstuale ose probleme të tjerë, të cilët veprojnë si ndihmë ose pengesë për rritjen e rezultateve. P. Sh.:

- Vështirësitë në plotësimin e stafit drejtues dhe mësimit;
- Riorganizimi i fundit i shkollës;
- Lëvizjet e nxënësve;
- Fakte të veçanta të rëndësishme në jetën e shkollës, si ndryshimet në stafin drejtues etj.

Shënim: Kini parasysh që jeni duke bërë analizë dhe vlerësim, jo përshkrim. Për çdo çështje, tregoni të dhënat ku jeni mbështetur. Nuk është nevoja të përsërisni të dhënat.

- *A ka pasur vështirësi në plotësimin e stafit drejtues dhe atij mësimit, të cilat kanë ndikuar në punën e shkollës?*
- *Cili është ndikimi, në çdo vit shkollor, i lëvizjes së nxënësve nga shkolla në shkollë, për shkak të kobës së keqe, epidemisë së gripit etj.?*
- *A ka plane për riorganizimin e shkollës?*
- *A ka ndryshime të dukshme në buxhetin e shkollës dhe cilat janë pasojat?*
- *A ka përfutur shkolla nga ndonjë inisiativë specifike? (Vlerësime të AVA, projekte të OJQ-ve, projekte të Bankës Botërore etj.). Si janë përdorur këto vlerësime për rritjen e performancës së shkollës? Cilat janë rezultatet? Cilat janë të dhënat e përdorura?*
- *A ka pasur probleme/ndryshime specifike, sidomos në lidhje me drejtimin dhe menaxhimin e shkollës?*
- *Cili është efekti i menaxhimit të shkollës?*
- *A ka probleme të akomodimit të nxënësve, të cilët ndikojnë në punën e shkollës ose dëmtojnë vazhdimësinë e punës së shkollës?*

1d Shënoni karakteristika të tjera të shkollës suaj, për të cilat kërkonti të tërhiqni vëmendjen e grupit inspektues.

Shënim: Kini parasysh që jeni duke bërë analizë dhe vlerësim, jo përshkrim. Për çdo çështje tregoni të dhënat ku jeni mbështetur. Nuk është nevoja të përsërisni të dhënat.

- *A ka pasur ndryshime të dukshme të karakterit të shkollës qysh nga inspektimi i fundit? P. Sh,: Numri i nxënësve, vendbanimet nga vijnë nxënësit, sistemimi i nxënësve në klasa, ndryshimet kryesore në staf?*
- *A ka pasur ndryshime të veçanta në arritjet e nxënësve të shkollës?*
- *Cili është buxheti i shkollë, përfshi edhe rrogat e mësuesve? Cili është ndikimi i tij?*
- *A ka marrë shkolla vlerësime të veçanta lokale/kombëtare?*
- *A është përfshirë shkolla në programe kombëtare?*

1e Paraqitni shkurt prioritetet kryesore të planit tuaj të përmirësimit/të punës dhe si është reflektuar aty konteksti në të cilin punoni.

- *A janë reflektuar problemet kryesore të identifikuara gjatë vetëvlerësimit? Mos shkruani më shumë se formulimet. Nëse shkolla ka status special, ai duhet të shprehet qartë.*

2. Mendimet e nxënësve, prindërve dhe të interesuarve të tjerë.

Cila janë mendimet e nxënësve, prindërve dhe të interesuarve të tjerë dhe si i keni njohur ato? (Të dhënat duhen paraqitur në kllapa në fund të pohimit tuaj).

2a Si i grumbulloni mendimet e nxënësve, prindërve dhe të interesuarve të tjerë, sa shpesh e bëni këtë dhe si siguroheni për paanshmërinë e informacionit?

- *A kini kryer vëzhgime/pyetsorë? (Të dhënat gjenden në ...)*
- *Si janë përfshirë nxënësit dhe prindërit në procesin e zbatimit të ligjit arsimor në shkollë? ()*
- *A përfshihen reagimet e nxënësve dhe prindërve në raportet e shkollës? Sa e përdorni këtë infomacion? ()*
- *A funksionon qeveria e nxënësve në shkollë?*
- *A ndërmerrni aktivitete të fokusuara në grup nxënësish/konferenca të nxënësve etj.? ()*
- *A i përdorni formatet e Manualit të Inspektimit/vetëvlerësimit? ()*
- *Çfarë mund të gjeni nga përdorimi i tyre? ()*
- *A i monitoroni ankesat dhe laudërimet? ()*

- *A i monitoroni nivelet e përfshirjes së nxënësve në aktivitetin ekstrakurrikular?* ()
- *A i monitoroni shërbimet plotësuese që ofron shkolla juaj?* ()
- *Çfarë rezultatesh keni nga puna me komunitetin, përfshi edhe përdorimin e komunitetit si burim të nxëni (të theksobet fort ne planet e punës së komunitetit për specialistët)?* ()

2b Cili është mesazhi i mendimeve të nxënësve, prindërve dhe të interesuarve të tjerë për standardet e nxënësve, zhvillimin e tyre personal dhe cilësinë e shkollës?

Shënim: Kini parasysh që jeni duke bërë analizë dhe vlerësim, jo përshkrim. Për çdo çështje tregoni të dhënat ku jeni mbështetur. Nuk është nevoja të përsërisni të dhënat.

Komentoni (duke u mbështetur në të dhëna dhe jo në fjali të pambështetura) mendimet e nxënësve dhe prindërve se:

- *Sa të kënaqur janë në shkollë;* ()
 - *Sa mirë funksionon shkolla;* ()
 - *Drejtesinë dhe barazinë midis grupeve të ndryshme;* ()
 - *Si konsultohet shkolla me ta, si u përgjigjet shqetësimeve dhe vepron ndaj ankimeve;* ()
 - *Sa mirë ndihmohen shkolla prindërit për të asistuar fëmijët e tyre të mësojnë;* ()
 - *Sa mirë ta ndjejnë se janë duke bërë progres;* ()
 - *Rrugët me të cilat shkolla punon me prindërit për të mbështetur të mësuarit, përfshi edhe shkëmbimin e të dhënave për objektivat, progresin dhe sjelljen e nxënësve;* ()
 - *Konsultimet me prindërit, përfshi edhe rrugët e grumbullimit të mendimeve të nxënësve dhe të reagimit ndaj tyre, si dhe si mbahen prindërit të informuar për jetën dhe punën në shkollë;* ()
 - *Si janë zgjidhur ankesat e prindërve; si veproni me to;* ()
 - *Standardet e sjelljes, përfshi edhe mendimet që kanë të bëjnë me detyrimin shkollor;* ()
- Komentoni:*
- *Efektin e aktiviteteve ekstrakurrikulare* ()
 - *Rrugët e përdorimit të INTERNIT/ web site, email;* ()
 - *Lidhjet produktive me shkolla të tjera;* ()
 - *Projekte të përbashkëta me shkolla të tjera, etj.* ()
 - *Burimet njerëzore, profesionale etj. të komunitetit, që mund t'i shërbejnë shkollës;* ()
 - *Numri i anëtarëve të komuniteti që përfitojnë nga shërbimet e ofruara prej shkollës? Cili është efekti i kësaj veprimtarie?* ()
 - *Cilat janë rezultatet e monitorimit të shkollës nga autoritetet lokale?* ()

2c Si i diskutoni me prindërit rezultatet që burojnë nga mendimet e tyre për shkollën?

Veç sa më sipër, kini parasysh edhe:

- Cila është struktura e takimeve me prindërit? ()
- Cilat janë mjetet e komunikimit me prindërit, përfshi njoftimet verbale, me shkrim etj.? ()
- Si e përdorni Internetin, email etj.? ()
- Si i përdorni mjediset e hyrjes së shkollës? ()

2d Mbështetur në mendimet e nxënësve, prindërve dhe të interesuarve të tjerë, a mund të jepni shembuj të veprimeve që keni ndërmarrë dhe të efektivitetit të tyre?

- A keni shembuj veprimesh që nuk i keni ndërmarrë (bashkë me arsyet)?
- A keni shembuj të rrugëve me të cilat të interesuarit kanë influencuar në prioritetet e pikës 1e? (Referohuni te komentet e seksionit të menaxhimit – Shiko Manualin).

Shënim: Kini parasysh që jeni duke bërë analizë dhe vlerësim, jo përshkrim. Për çdo çështje, tregoni të dhënat ku jeni mbështetur. Nuk është nevoja të përsërisni të dhënat.

- A keni shembuj të rrugëve nëpërmjet të cilave të interesuarit kanë influencuar në prioritetet e trajtuara në pikën 1e?
- A keni shembuj të veprimeve që keni vendosur të mos i ndërmerrni pas konsultimit (arsyeja përse)?
- Cili është ndikimi i këshillit të prindërve?

3. Rezultatet e nxënësve

Sa mirë mësojnë nxënësit?

Konsultimi me Manualin “Inspektimi i plotë i shkollës” ju ndihmon të trajtoni komentimin dhe gjykimet tuaja në këtë seksion.

Gjatë përgjigjeve të pyetjeve që vijojnë, pasqyroni të dhënat kryesore, si të dhënat për rezultatet e nxënësve, të vlerësimeve, të progresit të nxënësve të cilat jeni mbështetur në gjykimet tuaja (bëni kujdes të shmangni kopjimin e tabelave me të dhëna përshkruese).

3a Cilat janë arritjet e nxënësve në shkollë?

- **Standardet** që arrijnë nxënësit sipas rezultateve të tyre në teste dhe provime, duke marrë parasysh çdo dallim të dukshëm midis grupeve të nxënësve, lëndëve mësimore, cikleve; tendencat që vihen re, krahasimet me shkollat e tjera; nëse nxënësit arrijnë objektiva të guximshme;

- **Standardet aktuale** të punës së nxënësve në lidhje me objektivat e të nxënësve (duke shënuar çdo dallim të dukshëm midis rezultateve aktuale dhe atyre të mëparshme);
- **Progresi** i nxënësve në lidhje me gjendjen e tyre fillestare dhe aftësimin e tyre (duke shënuar çdo dallim të dukshëm midis grupeve të nxënësve dhe duke qartësuar nëse ka grupe që kanë rezultate të ulta, por që mund të kishin rezultate më të larta).

Shënim: Kini parasysh që jeni duke bërë analizë e vlerësim, jo përshkrim. Për çdo çështje tregoni të dhënat ku jeni mbështetur. Nuk është nevoja të përsërisni të dhënat. Mbështetuni në rezultatet e testeve të njohurive të nxënësve në fillimi të vitit shkollor, në analizën vjetore të shkollës dhe në rezultatet e testeve dhe të provimeve të mëparshme.

Progresi duhet vlerësuar në lidhje me njohuritë fillestare dhe aftësitë e nxënësve. Nëse ka ndryshime të dukshme midis cikleve, lëndëve ose grupeve, vlerësimi mund të jetë më i ulët se ai që sugjerojnë treguesit e përgjithshëm.

- *A janë rezultatet e shkollës dukshëm mbi ose nën mesataren kombëtare?*
- *A ka dallime të dukshme midis vlerësimeve në ciklet e ndryshme të shkollës?*
- *A ka dallime të dukshme midis rezultateve në lëndët mësimore themelore?*
- *A ka dallime të dukshme në vlerësimet e grupeve të ndryshme (gjinore, etnike, të nxënësve me nevoja speciale etj.)? Cili është ndikimi i tyre në rezultatet e përgjithshme?*
- *Çfarë mund të thojë shkolla për progresin që janë duke bërë grupet e mësipërme?*
- *Çfarë konkluzionesh të tjera mund të bëhen nga analiza e progresit të klasave në mekanizmat e raportimit të shkollës?*

Monitorimi i provimeve të lirimimit dhe të Maturës Shtetërore nga AVA krijon kushtet që shkollat të krahasohen me standardet kombëtare të arritjeve. Nëse ka ndryshime të dukshme midis cikleve, lëndëve ose grupeve vlerësimi mund të jetë më i ulët se ai që sugjerojnë treguesit e përgjithshëm.

- *Arritjet e vitit të fundit shkollor janë dukshëm mbi ose nën mesataren kombëtare? A ka dallime të dukshme në lidhje me rezultatet në fund të arsimit të detyruar?*
- *Cila është pesha në këto rezultate të nxënësve që nuk janë rregjistruar ose e atyre ngelës? (Shkolla e mesme)*
- *Rezultatet e tashmë janë dukshëm të larta ose të ulta? Këto rezultate janë në linjë/ më lart/ më poshtë se parashikimet? Pse?*

• *A është i dukshëm ndryshimi në arritjet nga viti në vit? Arritjet janë duke u përmirësuar apo janë në rënie?*

• *A ka dallime të mëdha midis lëndëve mësimore kryesore?*

• *A ka dallime të dukshme nga ato kombëtare në nivelet e ndryshme të shkollës? Cila është përqindja e nxënësve që arrijnë notat maksimale?*

• *Çfarë tregon analiza e shkollës për arritjet e grupeve 'vulnerabël' të nxënësve (gjinore, etnike, nxënësve me nevoja speciale etj.)?*

• *Si janë përdorur vlerësimet e brendshme për të gjykuar rreth performancës relative të shkollës?*

• *Cili është ndikimi i programeve monitoruese/ndërhyrëse?*

• *Progresi - çdo dallim i dukshëm në progresin lëndor?*

• *Cilat janë sistemet për ndjekjen e progresit të nxënësve dhe cili është rezultati i tyre?*

• *Çfarë tregojnë vëzhgimet dhe format e tjera të monitorimit për cilësinë e shprehive themelore në shkollë?*

Si i mat shkolla:

• *Arritjet/progresin e nxënësve?*

Si i mat shkolla:

• *Arritjet/progresin e nxënësve në lëndët jo kryesore?*

- *(të dbëna si e njëj)*

- *(vëzhgimet e shkollës në lëndët jo kryesore)*

• *Përmirësimet në frekuentim?*

• *A i njihni cilët janë nxënësit 'vulnerabël' të shkollës dhe rezultatet e tyre?*

• *Çfarë është duke bërë shkolla për ta?*

• *Si reagoni ndaj çdo dallimi të dukshëm midis grupeve të fëmijëve sipas:*

- *Gjinisë*

- *Etnisë*

- *Nxënësve të talentuar*

- *Nxënëve me nevoja speciale*

• *A ka dallime të dukshme në rezultatet e tyre gjatë kalimit nga njëri cikël në tjetrin? Cilat janë masat e marra?*

• *Cilat janë rezultatet e punës aktuale?*

- *Të dbëna*

- Puna vëzhguese
- Raportet monitoruese (të brendshme dhe të jashtme)
- Të dhënat e progresit për klasa/nxënës (semestrare)

- Cila është lidhja midis frekuentimit dhe rezultateve?
- Lidhja midis lëvizjeve të nxënësve dhe arritjeve?

Të dhëna – shprehitë bazë të punës

- Si po i fitojnë nxënësit shprehitë e punës?
- Pyetsorë nga ciklet/shkollat/punëdhënësit pasardhës?
- Opsione dhe të dhëna nga rezultatet e testeve, provimeve të lirimit, të Maturës Shtetërore, PISA-s etj.
- Cilat të dhëna përdorni?
- Si përdoren të dhënat dhe nga kush?

Shënim: Kur një shkollë ka/kërkon një status special, duhet të pasqyrohen edhe objektivat e shkollës që burojnë nga ky status.

3b Si janë rezultatet e nxënësve sipas Manualit Inspektimi i Plotë i Shkollës?

Pasqyrohen të dhënat për rezultatet e nxënësve për vitin shkollor në vazhdim. Rezultatet përfshijnë të gjitha lëndët dhe të gjitha klasat, krahasuar të paktën me rezultatet përkatëse të vitit të mëparshëm shkollor. Standardi kërkon pasqyrimin e rezultateve në 3 vitet e fundit shkollore.

3c Bazuar në vlerësimin tuaj, cilat janë prioritetet tuaja kryesore për zhvillimin e shkollës?

- Cilat janë konkluzionet që mund të nxirren nga analiza e mësipërme?
- A janë pasqyruar në planin e punës fushat kryesore të cilësisë së shkollës?
- Si i keni prioritetizuar fushat themelore të zhvillimit të shkollës?
- Cilët janë kriteret e suksesit?
- Si janë ata? Specifik dhe sasiorë?
- Çfarë mësoni nga pika 3a?
- Si mendoni të matni ndikimin e zhvillimit? (Ndonjë të dhënë)

- A janë mbështetur konkluzionet mbi të dhëna?
- Cilat janë sistemet/mekанизmat në përdorim?
- Cilat janë ndërhyrjet që bëni – si funksionojnë ato?

Referohuni te ‘Manuali Inspektimi i plotë i shkollës’

	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
Rezultatet dhe standardet e nxënësve në punën e tyre				
CF				
CL				
Shkolla e Mesme				

4. Zhvillimi personal dhe mbarëvajtja e nxënësve

Sa i mirë është zhvillimi personal dhe mbarëvajtja e nxënësve?

Gjatë përgjigjeve të pyetjeve që vijojnë, sqaroni të dhënat ku jeni mbështetur.

4a Cila është shkalla e sigurisë së nxënësve në shkollë?

- Nëse nxënësit ndjehen të sigurtë nga kërcënimet ose incidente raciste;
- Klima e bashkëpunimit midis stafit dhe nxënësve. Shkalla e besimit të nxënësve për të biseduar me stafin, nëse ndjehen të rrezikuar.

Shënim: Kini parasysh që jeni duke bërë analizë e vlerësim, jo përkrim. Për çdo çështje tregoni të dhënat ku jeni mbështetur. Nuk është nevoja të përsërisni të dhënat.

- Cila është gjendja e pajisjeve për edukimin fizik? A plotësohen kërkesat e programit mësimor? ()
- Cili është niveli i angazhimit/performancës së nxënësve? Cili është niveli i pjesëmarrjes në aktivitete ekstrakurrikulare; veçanërisht në ato sportive? ()
- A është e përfshirë shkolla në ndonjë lëvizje që ka lidhje me shëndetin? Nëse po, cilat janë rezultatet? ()
- Si është cilësia e ushqimit dhe ujit në mençë? (Shkollat me konviket/shkollat private) Cilat janë masat e shkollës për ushqim të shëndetsbëm? ()

- Cila është baza materiale për aktivitete jashtëshkollore

- Numri i mundësive?
- Kush është përfshirë?
- Rolet pjesëmarrëse?

Si kontribuon kjo në një stil jete të shëndetshëm?

- A bën shkolla pjesë në ndonjë shoqatë sportive?
- Kujdesi për fëmijët vulnerabël dhe impakti në arritjet e tyre
- Efekti i lidhjeve me shoqata/klube sportive

Edukimi fizik jashtëshkollor është për nxënësit të zgjedhur/vetëm gjatë pushimeve?

A ka një politikë për barazi midis seksëve dhe cili është kontributi i saj për një stil jete të shëndetshme?

Si kontribuojnë lëndët mësimore për një stil jete të shëndetshme?

Kontributi i komunikimit me prindërit për adoptimin e një stili jete të shëndetshme.

Si bashkëpunon shkolla me institucionet shëndetësore për nxitjen e një stili jete të shëndetshme?

Si është përfshirja e prindërve dhe cilat janë mendimet e tyre?

4b Cila është shkalla e kënaqësisë së nxënësve në shkollë?

- Shkalla e zbatimit të rregullores së disiplinës në mënyrë të ndërgjegjshme. Konsideroni qëndrimet, sjelljen dhe frekuentimin e nxënësve;
- Zhvillimin shpirtëror, moral, social, emocional dhe kulturor të nxënësve

Shënim: Kini parasysh që jeni duke bërë analizë e vlerësim, jo përshkrim. Për çdo çështje tregoni të dhënat ku jeni mbështetur. Nuk është nevoja të përsërisni të dhënat.

Si është gjendja shpirtërore në koridore dhe vendet e pushimit të shkollës? A monitorohet gjendja e banjave të shkollës? Si është transporti i nxënësve në shkollë? A ndjehen të sigurtë në mjediset përreth shkollës? ()

Cilat janë rezultatet e shkollës në monitorimin e dallimeve etnike ose të incidenteve detyruese? ()

Cili është efektiviteti i identifikimit, monitorimit, raportimit dhe zgjidhjes së incidenteve?

A mund të thuhet se proceset identifikuese, të lidhur me fëmijët vulnerabël, lejojnë mbështetjen e të gjithë nxënësve?

Ç'tregon kontrolli? Po pikëpamjet e nxënësve? Si dëgjohet zëri i nxënësve? P.sh., qeveria e nxënësve.

- Si reagon shkolla ndaj pikëpamjeve të prindërve lidhur me ardhjen në shkollë?
- Efekti i trajnimeve të stafit?
- Sa efektiv është modeli i rolit pozitiv të stafit?
- Cilat janë procedurat e përfundimit të ditës shkollore, sidomos kur fëmijët transportohen?
- Sa i ndërgjegjshëm është gjithsecili për problemet e sigurisë në shkollë? A efektivisht është komunikuar p.sh. rregullorja e disiplinës?

4c Sa mirë përgatiten nxënësit për mirëqenien e tyre të ardhme ekonomike?

- Shkalla e formimit të shkathtësive dhe cilësive personale që ndihmojnë nxënësit në këtë drejtim;
- Kontaktet e shkollës me shkollat nga vijnë/ku shkojnë nxënësit për t'i këshilluar dhe për të zbutur kalimin e tyre;
- Kuptimet e nxënësve për karrierën dhe përfitim të shprehive të punës;
- Kontaktet e shkollës (së mesme) me institucionet që ofrojnë vende pune, për të inkurajuar një orientim të përshtatshëm të nxënësve në tregun e punës.

Shënim: Kini parasysh që jeni duke bërë analizë e vlerësim, jo përshkrim. Për çdo çështje tregoni të dhënat ku jeni mbështetur. Nuk është nevoja të përsërisni të dhënat.

- Çfarë sugjerojnë të dhënat për frekuentimin e nxënësve? ()
- A është i rregullt frekuentimi i nxënësve? A janë të përpiktë në mësim? ()
- Ç'të dhëna për kënaqësinë e nxënësve rezultojnë nga vëzhgimi i mësimave? ()
- Si janë arritjet e nxënësve? (Ky mund të jetë një tregues i mirë i kënaqësisë). ()
- Sa mirë kontribuon vlerësimi i mësimnxënies në pjesëmarrjen e nxënësve në mësim dhe në kënaqësinë e tyre?
- A e respektojnë nxënësit njëri-tjetrin? Cilat janë rezultatet e monitorimit të sjelljes.
- A shfaqin sjellje pozitive nxënësit? Ç'tregojnë të dhënat për përjashtimet e nxënësve? ()
- Sa të prirur janë nxënësit për të kontribuar në mësim? ()
- Cila është shkalla e inkurajimit të nxënësve për të qenë nxënës të pavarur?
- A janë të rregullta konsultimet e nxënësve?
- A janë krijuar mundësi që nxënësit të reflektojnë rreth përvojës së tyre në shkollë dhe rreth mësimnxënies?
- A është krijuar një mjedis shkollor i pëlqyeshëm për nxënësit?
- Sa të sigurtë ndjehen nxënësit nëse guxojnë të zhvillojnë më tej punën e tyre?

<ul style="list-style-type: none"> • <i>Sa efektive është shkolla pasqyron dhe merr parasysh shoqërinë tonë shumëkulturore?</i>
<ul style="list-style-type: none"> • Nëse e gjykoni të përshtatshme, bëni referime specifike për përfshirjen e nxënësve në specialitetin e shkollës. (Profesionale)
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Sa mirë janë zhvilluar shprehjet themelore (p.sh., puna në grupe)? ()</i>
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Çfarë ndërhyrjesh janë bërë për të përmirësuar shprehjet bazë të nxënësve të dobët?</i>
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Cili është raporti i nxënësve që ndjekin kurse profesionale? Cilët janë treguesit e suksesit? (CL dhe shkolla e mesme)</i>
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Cili është niveli i pjesëmarrjes në praktikën profesionale dhe si janë monitoruar rezultatet? Ç'tregon monitorimi? (Profesionale)</i>
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Sa efektiv janë informacioni, këshillat dhe udhëzimet për karrierën? (CL dhe shkolla e mesme)</i>
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Sa efektive janë veprimet e ndërmarra për mbështetjen e nxënësve vulnerabël për një të ardhme me mirëqenie të mirë?</i>
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Si i frymëzon shkolla aspiratat e nxënësve për rolet e tyre të ardhme? P.sh., lidhjet e jashtëme.</i> • <i>Si i analizon shkolla stereotipet?</i> • <i>Si i përfshin prindërit në frymëzimin e aspiratave të nxënësve?</i> • <i>Cili ka qenë rezultati i kësaj përfshirje?</i>
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Si përfshihet biznesi lokal në këshillat për karrierën?</i>
<ul style="list-style-type: none"> • Nëse e gjykoni të përshtatshme, bëni referime specifike për përfshirjen e nxënësve në specialitetin e shkollës. (Profesionale)

4d Bazuar në vlerësimin tuaj, cilat janë prioritetet kryesore për zhvillim?

<ul style="list-style-type: none"> • <i>Ç'konkluzione mund të nxirren nga analiza e mësipërme?</i>
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Cilat janë zhvillimet e kërkuara në lidhje me zhvillimin dhe mbarëvajtjen e nxënësve në shkollë?</i>

Plotësoni tabelën që vijon, mbështetur në vlerësimet tuaja sipas shkallës vlerësuese me katër nivele.

		Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
Zhvillimi i përgjithshëm personal i nxënësve	Për shkollën				
	CF				
	CL				
	Klasa 1 ShMesme				
	Klasa 2 ShMesme				
	Klasa 3 ShMesme				
	Klasa 4 ShMesme				
	Klasa 5 ShMesme				

5. Cilësia e masave të ndërmarra

5a Sa e mirë është cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies?

- Sa mirë i plotëson mësimdhënien nevojat e nxënësve dhe ato të programit mësimor;
- Përshtatshmëria dhe rigoriziteti i vlerësimeve në planifikimin e mësimnxënies dhe monitorimin e progresit të nxënësve;
- Diagnoza dhe kushtet sipas nevojave individuale të mësimnxënies;
- Përfshirja e prindërve në mësimnxënien dhe zhvillimin e nxënësve.

Të dhënat më të qarta të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies do të rezultojnë nga konkluzionet rreth standardeve, progresit dhe zhvillimit profesional të nxënësve. Konkluzionet për mësimdhënien dhe mësimnxënien nuk duhet të jenë rezultat i një grupi vëzhgimesh të thjeshta të mësimve.

<ul style="list-style-type: none"> • Çfarë ju tregon progresi i nxënësve rreth cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies? (.....)
<ul style="list-style-type: none"> • Çfarë ju tregon zhvillimi personal i nxënësve rreth cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies? ()
<ul style="list-style-type: none"> • Cilat janë rezultatet e monitorimit të mësimve? () • Cilat janë pikat tona të forta dhe të dobta të mësimdhënies dhe mësimnxënies? • Cili është vlerësimi i shkollës rreth profilin e cilësisë së saj në mësimdhënien? • Si e keni forcuar/përmirësuar cilësinë e mësimdhënies në kontekstin e gjithë shkollës dhe të gjithë individëve? • Cilat janë rezultatet e monitorimit të jashtëm nga DAR dhe institucione të tjera? ()
<ul style="list-style-type: none"> • Cilat janë rezultatet e analizës së punës së nxënësve? ()
<ul style="list-style-type: none"> • Cilat janë rezultatet e diskutimeve, ose të vëzhgimeve të strukturuar me prindërit, stafin dhe nxënësit?
<ul style="list-style-type: none"> • Çfarë tregon planifikimi i stileve të mësimdhënies dhe të nxënësve, si niveli i sfidës, marrëdhëniet midis

nxënësve, përdorimi i materialeve mësimore rreth performancës së grupeve specifike në lëndëve dhe mësuesve në drejtim të mësimnxënies efektive?

Sa mirë e mbështet mjedisi mësimor mësimdhënien dhe mësimnxënien?

- *Cilat janë prioritetet tona për përmirësimin e mësimnxënies?*
- *Grumbullimi sistematik, analiza dhe përdorimi i të dhënave për performancën.*
- *Mësuesit e përdorin vlerësimin si pjesë të natyrshme të procesit të të nxënësve.*
- *Planet mësimore dhe ditaret janë hartuar në bazë të një analize të kujdesshme të nevojave mësimore të nxënësve dhe përdoren nga të gjithë mësuesit kur i hartojnë dhe i zbatojnë në mësimet e tyre.*
- *Vlerësimet dhe objektivat e vendosur u ofrojnë nxënësve dhe prindërve të tyre një tablo të qartë të progresit të tyre dhe të asaj që duhet bërë për përmirësim të mëtejshëm.*

- *Cila është cilësia e mësimdhënies/mësimnxënies për grupe specifike nxënësish?*

- *Çfarë masash janë marrë për të aftësuar prindërit të mbështetin të mësuarit e nxënësve?*

- *Çfarë aktiviteteesh jashtë klase (kurse private, aktivizim në punë) zhvillojnë nxënësit për zhvillimin e kompetencave të tyre mësimore?*
- *Cilat janë rezultatet e diskutimeve, ose të vëzhgimeve të strukturuar me prindërit, stafin dhe nxënësit?*
- *Kur dhe si ka ndikuar përfshirja e prindërve në mësimnxënien e nxënësve?*

- ***Nëse shkolla gëzon një status special, mund të, bëni referime rreth faktit se si ky status ka forcuar dhe zhvilluar mësimdhënien dhe të nxënësve në lëndët e specialitetit.***

5b Sa mirë kurrikula dhe aktivitete të tjera mësimore përputhen me diapazonin e nevojave dhe interesave të nxënësve?

- Shkalla me të cilën tekstet alternative të zgjedhura, ose aktivitetet mësimore plotësojnë nevojat e nxënësve (4.4);
- Shkalla me të cilën pajisjet e shkollës inkurajojnë nxënësit të ndjehen mirë dhe të sigurtë; (3.3/4.5);
- Shkalla e mundësive që u ofrohen nxënësve, për të zhvilluar shprehje të të mësuarit dhe të punës në grup (10);
- Shkalla e përfshirjes së nxënësve në aktivitete mësimore në shërbim të rritjes së rezultateve të tyre (6.6).

Përsëri, të dhënat e duhura të cilësisë së kurrikulës dhe aktiviteteve të tjera do të rezultojnë nga konkluzionet rreth standardeve, progresit dhe zhvillimit profesional të nxënësve. Rezultati është më i rëndësishëm se synimi ose ballafaqimi me modele të ndryshme. Tabloja inspektuese (Manuali inspektimi i Plotë i Shkollës) është duke u bërë efektive për shkak të thjeshtimit të procesit të vlerësimeve.

Shënim: Kini parasysh që jeni duke bërë analizë e vlerësim, jo përshkrim. Për çdo çështje tregoni të dhënat ku jeni mbështetur. Nuk është nevoja të përsërisni të dhënat.

<ul style="list-style-type: none"> Çështja themelore është: cila është shkalla me të cilën zbatimi i kurrikulës, tekstet alternative dhe aktivitete të tjera mësimore plotësojnë nevojat, aspiratat, aftësitë e nxënësve, bazuar në arritjet dhe përvojën e mëparshme? ()
<ul style="list-style-type: none"> Sa efektive janë tekstet alternative në plotësimin e nevojave të të gjithë nxënësve, përfshi edhe nxënësit e talentuar, ata me probleme specifike, grupet etnike etj. () Si sigurohemi se janë plotësuar nevojat e të gjithë nxënësve?
<ul style="list-style-type: none"> Cila është cilësia e masave për leximin, gjuhën, letërsinë, matematikën dhe teknologjinë e informacionit? ()
<ul style="list-style-type: none"> Si i njohim njohuritë e mëparshme të nxënësve (përfshi edhe testimet e fillimit të vitit shkollor)?
<ul style="list-style-type: none"> Si sigurohemi se planifikimi është bazuar në të dhënat e vlerësimit (evidencat monitoruese)?
<ul style="list-style-type: none"> Si e ndjekim progresin e nxënësve në të gjitha lëndët mësimore?
<ul style="list-style-type: none"> Si punojmë për organizimin e aktiviteteve kroskurrikulare në shërbim të pasurimit të kurrikulës shkollore? (Planifikimi)
<ul style="list-style-type: none"> A dëgjohet “zëri i femijëve” për të marrë parasysh interesat individuale në strategjitë e planifikimit/mësimdhënies? (forumi i nxënësve, qeveria e nxënësve, pyetësorët, vëzhgime dhe vlerësime)
<ul style="list-style-type: none"> Si pasqyrohet etika e shkollës në formulimin e misionit të saj? Cila është shkalla me të cilën zbatimi i kurrikulës dhe i aktiviteteve të tjera reflektojnë vlerësimin e kontekstit të shkollës suaj, të paraqitur në Seksionin 1? Sa efektive është kurrikula në plotësimin e nevojave të gjithë nxënësve? Sa mirë realizohet kurrikula duke u mbështetur në njohuritë e mëparshme dhe duke siguruar vazhdimësi në kalimin nga një cikël në tjetrin? Zbatimi i kurrikulës sipas udhëzimeve shtetërore.
<ul style="list-style-type: none"> Si i feston shkolla sukseset e nxënësve jashtë saj? Cili është ndikimi i këtyre sukseseve? (Lidhjet me institucione të ndryshme, vizita, projekte)
<ul style="list-style-type: none"> Cili është ndikimi i trajnimit të stafit në lidhje me iniciativat/strategjitë/etikën e shkollës?
<ul style="list-style-type: none"> Si reagon shkolla ndaj kërkesave/vlerësimeve të jashtme? (raportet e kësbilluesve, raportet e inspektimit, monitorimi i ZA/DAR) Si ndikojnë bashkëpunimet lokale në kurrikulën dhe aktivitetet ekstrakurrikulare?
<ul style="list-style-type: none"> Si punon shkolla për jetë të shëndetshme të nxënësve? (programe shëndetësore, iniciativa për eskursionë në këmbë, programe kundër drogës, kundër duhanit etj.)
<ul style="list-style-type: none"> Si është niveli i sigurisë emocionale dhe fizike të nxënësve? (ardhja/largimi i nxënësve; shmangia e detyrimeve)

- *Sa efektive është punëbërja kundër racizmit, dhunës dhe për respektimin e kulturave të ndryshme?*
- *Sa efektive janë masat e shkollës për të siguruar mbarëvajtjen e nxënësve, si dhe shëndetin e tyre mendor dhe fizik?*
- *Cili është ndikimi i të mësuarit në shtëpi?*
- *Cili është efekti i përfshirjes së ZA/DAR në jetën e shkollës suaj? (kurrikula, vizita të specialistëve të sektorëve të ZA/DAR)*
- ***Nëse shkolla gëzon një status special, mund të bëni referime rreth faktit se si ky status ka forcuar dhe zhvilluar zbatimin e kurrikulës, formimin profesional të nxënësve etj. Referencat duhet të pasqyrojnë punën e shkollës për realizimin e mundësive të formimit profesional të nxënësve, duke përfshirë edhe biznesin lokal.***

5c Sa mirë udhëhiqen dhe mbështeten nxënësit?

- Kujdesi i përditshëm që tregon shkolla ndaj nxënësve të saj; mbështetja e tyre për rezultate të mira (8.5);
- Shkalla e veprimtarive për përfshirjen e nxënësve në mësim;
- Shkalla e vëmendjes dhe e respektit që tregojnë mësuesit ndaj nxënësve;
- Cilësia e politikës së shkollës gjatë formimit të klasave sipas potencialeve të nxënësve.

Çfarë tregojnë rezultatet e performancës (progresi i nxënësve, frekuentimi, përjashtimet, përparimi i nxënësve të dobët etj.) për cilësinë e kujdesit, udhëheqjes dhe mbështetjes që tregon shkolla për nxënësit?

Kujdes!

Inspektorët presin që shkolla të jetë e përgatitur të flasë për kontributin e masave që ka marrë në rezultatet e shkollës.

Shënim: Kini parasysh që jeni duke bërë analizë e vlerësim, jo përshkrim. Për çdo çështje tregoni të dhënat ku jeni mbështetur. Nuk është nevoja të përsërisni të dhënat.

- *Cilat janë objektivat (mësimore dhe personale) të shkollës? Si është monitoruar/raportuar progresi i nxënësve në lidhje me to? Si janë mbështetur/kësbilluar nxënësit për plotësimin e objektivave të tyre? ()*
- ***Si kujdeset shkolla për nxënësit vulnerabël, veçanërisht për ata me nevojë fizike dhe mendore? (Kujdes! Ekipi i inspektimit do të testojë efektivitetin e procedurave të shkollës suaj duke analizuar një grup nga fëmijët “vulnerabël. Prandaj, rekomandohet që edhe ju ta vlerësoni këtë aspekt në të njëjtën mënyrë si edhe inspektimi).***
- *Cili është sistemi i punës për ripërfshirjen e nxënësve që frekuentojnë me hope dhe atyre të larguar?*
- *A është shpërblyer shkolla juaj me ndonjë certifikatë për punën që bën për shëndetin, për karrierën e nxënësve etj. ()*

- Cila është cilësia e sistemit të shpërblimeve që përdor shkolla? ()
- Cilat janë të dhënat që tregojnë se strategjitë e të mësuarit të personalizuar kanë efekt te secili nxënës?
- Sa efektive janë mekanizmat e shkollës për njohjen dhe mbështetjen e nxënësve të talentuar?
- Cilat janë procedurat e sistemit monitorues?
- Cila është shkalla me të cilën sistemet monitoruese identifikojnë/realizojnë përmirësim të frekuencimit të nxënësve?
- Sa efektive janë mekanizmat tuaj për të dëgjuar zërin e nxënësve, p.sh., të atyre që dhunohen?
- Si ka influencuar punonjësi social në shëndetin mendor dhe mbarëvajtjen e nxënësve ne shkollë?

- Cila është cilësia dhe mundësia për informacion, këshillim dhe udhëbeqje të nxënësve në lidhje me lëndët dhe programet mësimore? Lidhni vlerësimin tuaj me rezultatet ()

- Cila është cilësia e masave për sigurinë e nxënësve, përfshi procedurat e mbrojtjes, të vlerësimit të rrezikut? A bëhen trajnimet e dubura ? ()

- Sa efektive janë bashkëpunimet komunitare për zhvillimin e mbarëvajtjes emocionale, fizike dhe sociale të nxënësve?

- Cilat janë të dhënat që tregojnë se mekanizmat për përfshirjen e prindërve kanë ndikuar në zhvillimin dhe mbarëvajtjen e të gjithë nxënësve?

Familjet - Prindërit

- Si janë konsultuar dhe përfshirë prindërit në mbarëvajtjen dhe mësimnxënien e nxënësve?
- Si janë ndërgjegjësuar prindërit me origjinë të ndryshme sociale dhe etnike për masat dhe procedurat e shkollës?
- Si e identifikoni dhe e përdorni informacionin për përvojat e mëparshme dhe të nevojave të tashme të nxënësve?
- Si punon shkolla me prindërit dhe fëmijët e tyre për aktivitetet (sociale) jashtëshkollore?
- Si sigurohet shkolla se nxënësit janë edukuar me njohuritë dhe përvojën e dubur për jetën pas shkollës?

5d Bazuar në vlerësimin tuaj, cilat janë prioritetet kryesore për zhvillim?

- Çfarë konkluzionesh mund të nxirren nga analiza e mësipërme?

5e Përcaktoni nivelet e vlerësimit për çështjet që vijojnë. Për këtë konsultohuni me *Manualin Inspektimi i Plotë i Shkollës*.

		Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
Cilësia e mësim-dhënies të nxënësit	Për shkollën				
	CF				
	CL				
	ShMesme				
Cilësia e teksteve alternative dhe aktiviteteve të tjera	Për shkollën				
	CF				
	CL				
	ShMesme				
Cilësia e kujdesit dhe e mbështetjes	Për shkollën				
	CF				
	CL				
	ShMesme				

6. Menaxhimi i shkollës

Gjatë plotësimit të këtij seksioni duhet të konsultoheni me Manualin Inspektimi i Plotë i Shkollës.

Vlerësimi juaj për cilësinë e menaxhimit duhet të marrë në konsideratë impaktin e tij në rezultatet e nxënësve dhe cilësinë e masave të ndërmarra.

Gjatë përgjigjes së pyetjeve që vijojnë, paraqisni të dhënat kryesore ku jeni mbështetur.

6a Cilat janë efektiviteti dhe eficientia e përgjithshme e menaxhimit të shkollës suaj?

- Sa efektivë janë anëtarët e ekipit menaxhues të shkollës në vendosjen e drejtimeve të qarta për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimorë që ofron shkolla juaj;
- Sa efektivisht monitorohet performanca dhe përmirësimi i saj në funksion të plotësimit të objektivave (1.4) nëpërmjet vetëvlerësimit;
- Sa mirë zbatohet parimi i barazisë së shanceve (8.3/11.1) në mënyrë që të gjithë nxënësit të përfshihen në mësim (12.3);
- Përshtatshmëria e stafit, bazës materiale mësimore dhe e klasave, si dhe shkalla e përdorimit të tyre (3);
- Efektiviteti i lidhjeve me të interesuarit e tjerë (5.4-5.6/11.6) në shërbim të përmirësimit të mësimnxënies;
- Shkalla me të cilën anëtarët e ekipit menaxhues të shkollës ushtrojnë përgjegjësitë e tyre.

Shënim: Kini parasysh që jeni duke bërë analizë dhe vlerësim, jo një përshkrim. Për çdo çështje, tregoni të dhënat ku jeni mbështetur. Nuk është nevoja të përsërisni të dhënat.

Pikë nisëse për vlerësimin e menaxhimit është efekti i tij në progresin dhe zhvillimin personal të nxënësve, si dhe në cilësinë e mësimdhënies, të zbatimit të kurrikulës dhe të kujdesit për nxënësit. Cilësia e këtij vetëvlerësimi në të gjithë planin, në vetvete, do të jetë treguesi i efektivitetit.

<ul style="list-style-type: none"> • A janë duke u rritur standardet në përputhje me objektivat e shkollës për përmirësim? () • A ka shkolla objektiva ambicioze? ()
<ul style="list-style-type: none"> • A ka një drejtim të qartë të orientimit të shkollës drejt përmirësimit dhe cilësisë së lartë të shërbimit arsimor që ofron shkolla? Si është artikuluar? A është kuptuar ky drejtim dhe a mbështetet nga komuniteti shkollor dhe sidomos nga stafi drejtues e ZA/DAR? A ka ndonjë të dhënë që dëshmon koherencën midis prioriteteve strategjike dhe planit të zhvillimit të shkollës? () • Cilat janë konkluzionet e ZA/DAR për efektivitetin e shkollës? ()
<ul style="list-style-type: none"> • A ka marrë shkolla ndonjë shpërblim? ()
<ul style="list-style-type: none"> • Sa efektive janë masat për monitorimin e performancës nëpërmjet ruajtjes së cilësisë dhe vetëvlerësimit? Cili është qëndrimi i shkollës ndaj vetëvlerësimit? Cili është modeli/manuali/udhëzimet që jeni duke përdorur? ()
<ul style="list-style-type: none"> • Cilat janë shembujt e dobësive që keni trajtuar? ()
<ul style="list-style-type: none"> • A ka procedura të vlerësimeve të plota dhe analitike për të ofruar një tablo të saktë të problemeve të progresit të nxënësve dhe të zhvillimit personal në secilën lëndë mësimore? ()
<ul style="list-style-type: none"> • Ç' të dhëna ka për barazinë e mundësive dhe shmangien e diskriminimeve, në mënyrë që të gjithë nxënësit të arrijnë potencialin e tyre (p.sh., përfshirjen)? ()
<ul style="list-style-type: none"> • Cila është shkalla e përshtatshmërisë dhe e kualifikimit profesional e stafit mësimor? ()
<ul style="list-style-type: none"> • Cilat janë të dhënat për përfshirjen e ZA/DAR në formulimin e vizionit të shkollës, identifikimin e pikave të forta dhe i dobësive, si dhe në monitorimin e efektit të strategjive përmirësuese të shkollës? ()
<ul style="list-style-type: none"> • Si sigurohen ZA/DAR se shkolla funksionon sipas kërkesave përkatëse ligjore, përfshi këtu edhe politikat e saj përfshirëse lidhur me problemet e racës, paafësisë dhe seksit? • A kanë rezultuar probleme gjatë monitorimit përkatës? ()
<ul style="list-style-type: none"> • Ç' të dhëna ka për mbështetjen që ka marrë stafi drejtues nga ZA/DAR?

6b Bazuar në vlerësimin tuaj, cilat janë prioritetet kryesore në fushën e menaxhimit të shkollës suaj?

6c Përcaktoni nivelin e vlerësimit për fushën e menaxhimit, sipas udhëzimeve të Manualit Inspektimi i Plotë i Shkollës

		Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
Efektiviteti dhe eficientia e menaxhimit	Për shkollën				
	CF				
	CL				
	ShMesme				

7. Efektiviteti dhe eficientia e përgjithshme

Sa efektiv dhe eficient është shërbimi arsimor i ofruar, kujdesi për nxënësit dhe çdo shërbim tjetër, i ofruar për plotësimin e nevojave të nxënësve dhe pse?

Për t'iu përgjigjur pyetjeve që vijojnë, duhet të përdorni edhe vlerësimet në seksionet e mëparshme. Manuali Inspektimi i Plotë i Shkollës ju ndihmon në plotësimin e duhur të këtij seksioni.

Gjatë përgjigjes së pyetjeve pasqyroni të dhënat kryesore, mbi të cilat është mbështetur vlerësimi juaj.

7a Cili është efektiviteti i përgjithshëm i shërbimit arsimor të ofruar, përfshi edhe shërbime të tjera, dhe cilat janë pikat e forta si dhe dobësitë e tij?

Konkluzioni për efektivitetin e përgjithshëm duhet të jetë rezultat i gjithë vlerësimeve të tjera për performancën e shkollës. Ai duhet formuluar në bazë të vlerësimit të përfundimeve që burojnë nga pyetjet që vijojnë:

- Ç'progres ka bërë shkolla, krahasuara me objektivat të saj?
 - Cila është performanca e shkollës, krahasuar me shkolla të ngjashme?
 - Sa i mirë është progresi dhe zhvillimi personal i nxënësve?
 - Cila është cilësia e masave të shkollës, sidomos për mësimdhënien dhe kujdesin për nxënësit?
 - Sa efektiv është menaxhimi i shkollës?
 - Cili është emri që gëzon shkolla tek prindërit, nxënësit dhe komuniteti lokal?
 - Sa efektive janë lidhjet e jashtme të shkollës?

7b Cili është efektiviteti i çdo hapi për përmirësim qysh nga inspektimi i fundit, i ndërmarrë si rezultat i vetëvlerësimit tuaj?

- Si janë trajtuar problemet e identifikuara nga inspektimi i fundit i shkollës? Cilat janë arsyet për ndonjë problem që rezultoi i vonuar? ()

- A ka ndryshuar performanca e shkollës qysh nga inspektimi i fundit? ()

- A janë përmirësuar rezultatet apo ruajtur, nëse janë të mira? ()

- Çfarë ndryshimesh kanë ndodhur në frekuencimin e nxënësve? ()

- Çfarë thotë vetëvlerësimi për cilësinë e mësimdhënies/mësimnxënies, krahasuar me inspektimin e fundit? ()

- Çfarë thotë vetëvlerësimi për cilësinë e menaxhimit, krahasuar me inspektimin e fundit? ()

Për të vlerësuar, referohuni tek:

- Përfshirja e stafit të shkollës në nisma për zhvillimin profesional, për përmirësimin e prioriteteve dhe objektivave të shkollës; ()

- Përmirësimi i kurrikulës nëpërmjet teksteve alternative dhe mundësive mësimore jashtë mësim; ()

- Emërimi i stafit të ri mësimor të përshtatshëm, plus rritja e kapacitetit të stafit ekzistues; ()

- Përfshirja në rritje të prindërve për mbështetjen e mësimnxënies në shkollë dhe në familje; ()

- Efekti i nismave kombëtare; ()

- Rezultatet e monitorimit të mësimdhënies/mësimnxënies; ()

- Rritjes së përfshirjes së ZA/DAR. ()

- Nëse është e nevojshme, referohuni tek aktivitetet përmirësuese që rezultojnë nga statusi special i shkollës.

7c Cili është kapaciteti për të bërë përmirësim të mëtëjshëm?

Cilësia e menaxhimit, jo efektiviteti i procesit të vetëvlerësimit, është rruga më e mirë për përmirësimin e kapacitetit të shkollës për zhvillimin e nxënësve.

- *Cila është shkalla me të cilën menaxhimi diagnostikon pikat e veta të forta dhe të dobta, për rritjen e standardeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor që ofron shkolla?*
- *Sa mirë e monitoron shkolla performancën e saj, veçanërisht mësimdhënien dhe progresin e nxënësve?*
- *Cili është qëndrimi i shkollës ndaj vetëvlerësimit? Cilin model të vetëvlerësimit përdor shkolla? Cilat janë materialet mbështetëse për këtë proces?*
- *Cilat janë të dhënat që tregojnë suksesin e menaxhimit për të siguruar përmirësim të cilësisë së shërbimit arsimor që ofron shkolla?*

7d Sa efektive janë lidhjet me organizatat e tjera për nxitjen e mbarëvajtjes së nxënësve?

- *Pika nisëse për vlerësimin e këtyre lidhjeve është ndikimi i tyre në progresin dhe zhvillimin personal të nxënësve, si dhe të cilësisë së mësimdhënies, zbatimit të kurrikulës dhe kujdesit për nxënësit.*
- *Sigurisht, nëse shkolla ka status special, duhet të pasqyrohen specifikat e këtij statusi. P.sh., shkollat profesionale mund të mbështeten nga donatorët të ndryshëm.*

7e Cilat janë hapat që duhen ndërmarr për përmirësim të mëtëjshëm?

- *Çfarë konkluzionesh rezultojnë nga analiza e mësipërme?*

7f Përcaktoni nivelin e vlerësimit për çështjet që vijojnë, sipas udhëzimeve të Manualit Inspektimi i Plotë i Shkollës.

	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
Efektiviteti i përgjithshëm				
Kapaciteti për të kryer përmirësim të mëtëjshëm				
Përmirësimi qysh nga inspektimi i fundit				

SI TË PLOTËSOJMË NJË FORMAT VETËVLERËSIMI QË FUNKSIONON

Nuk mund të realizohet një plotësimi i përkryer i formatit të vetëvlerësimit dhe inspektorët e njohin këtë fakt. Megjithatë, për të qenë të sigurtë se plotësimi i formatit të vetëvlerësimit është kryer mirë, ka disa faktorë që duhen pasur parasysh. Konkretisht:

Formati juaj i vetëvlerësimit duhet:

- Të ofrojë një tablo të qartë të asaj se sa mirë është duke punuar shkolla juaj;
- Të japë prova të asaj se si ju e njihni këtë tablo dhe çfarë njihni;
- Të tregojë se ju mbështeteni tek sukseset dhe përmirësoni pikat e dobta.

PARA SE TË SHKRUANI DIÇKA

MENDONI:

Cilët janë mesazhet kryesore që doni të ofroni? Si do t'i formuloni gjetjet tuaja për një drejtues të ri të ZA/DAR dhe për prindërit e interesuar?

SHIKONI INTERNETIN DHE ÇFLETONI literaturë, sepse mund të gjeni shumë informacion të dobishëm.

LEXONI manualët, udhëzimet dhe shikoni mënyrën se si punojnë shkollat pilot, të përfshira në procesin e vetëvlerësimit. Ky manual është një ndihmë e madhe për ju. Përvoja të suksesshme të vetëvlerësimit mund të gjeni edhe në faqen e Drejtorisë së Inspektimit dhe të gazetës “Mësuesi” në website-in e MASH në adresën: www.mash.gov.al

Lexoni me vëmendje udhëzimet dhe modelet e këtij manuali para se të filloni. Mund t'ju duket se nuk do të keni vështirësi në plotësimin e formatit të vetëvlerësimit të shkollës suaj për shkak të përvojës suaj. Por, nuk është kështu, sepse procesi i vetëvlerësimit nënkupton shumë çështje të reja. Jo më kot vetëvlerësimi konsiderohet si proces që siguron një lidhje të re me shkollën, e cila përmirësohet nëpërmjet vetëvlerësimit.

KUR FILLONI TË SHKRUANI

Mendoni për rezultatet e nxënësve.

Nëse jeni i qartë për progresin që kanë nxënësit në mësimnxënie dhe zhvillimin e tyre personal, do ta keni të lehtë të bëni lidhjet me seksionet e tjerë. P.sh., inspektorët presin të shohin një lidhje

midis progresit të bërë nga nxënësit dhe efektivitetit të menaxhimit të shkollës. Ndërkaq, seksionin për efektivitetin e përgjithshëm të menaxhimit plotësojeni në fund.

Inspektorët do të analizojnë dhe do të ngrejnë hipoteza, bazuar në të dhënat që kanë grumbulluar para inspektimit të shkollës suaj. Ata presin që ju t'i kini përdorur të dhënat në mënyrën e duhur. Kjo nuk ka nevojë për ripërsëritje të tyre, por ju duhet të tregoni se si i kini përdorur ato dhe çfarë veprimesh keni ndërmarrë, si rezultat i analizës suaj. Ju duhet të ofroni të dhëna që nuk janë publike; nuk është nevoja të përsëritni të dhënat, por të shpjegoni se çfarë tregojnë ato dhe si i keni përdorur. Kjo është arsye përse në këtë manual ne e përsëritim vazhdimisht këtë këshillë.

VLERËSIMI

Formati i vetëvlerësimit nënkupton diçka që duhet vlerësuar; këtu nuk është fjala për një koment përshkrues të historisë së shkollës suaj. Nëse nuk jeni në gjendje të tregoni nevojat tuaja në një material me 20 faqe, atëherë të jeni të sigurtë se jeni duke **përshkruar** dhe jo duke **analizuar ndikimin** e asaj që bëni. Kini gjithmonë parasysh, se jeni duke u përpjekur të ofroni atë që nxënësit, prindërit dhe të interesuarit e tjerë mendojnë për shkollën tuaj dhe jeni duke bërë një vlerësim të përmbledhur.

Sigurohuni se i kini të qarta pyetjet e formatit të vetëvlerësimit. Zakonisht, ato përputhen me pyetjet që bëjnë inspektorët gjatë inspektimit. Përgjigjet tuaja shërbejnë si orientues të inspektorëve. Trajtoni problemet më të rëndësishme në përgjigjet e secilës pyetje. Përdorni rekomandimet e paraqitura në pjesën e fundit të këtij Manuali.

Gjatë vlerësimit të punës së shkollës dhe të menaxhimit të saj, është e rëndësishme t'i lidhni këto aspekte me impaktin e tyre. Udhëhiquni nga ky mesazh: Nëse nxënësit po mësojnë mirë, cili është roli që po luani si lehtësues i rezultateve të tyre?

Bëni maksimumin për të qenë i saktë dhe i ndershëm. Vlerësimet dhe konkluzionet mbështetini në të dhëna dhe jo në atë që mund të kishte ndodhur, apo në atë që prisni të ndodh në këtë apo atë aspekt të punës në shkollë.

Shprehuni qartë. Përmbledhja që keni përgatitur dhe disa nga prioritetet kryesore të cilësisë së shërbimit arsimor që ofron shkolla juaj duhet të jenë të lehta për t'u lexuar dhe që mund të njihen nga stafi, ZA/DAR dhe të interesuarit e tjerë.

Procesi i vetëvlerësimit është diçka e re për shkollat tona. Ju duhet të jeni të ndërgjegjshëm për këtë tipar gjatë gjithë procesit të vetëvlerësimit. Vazhdimisht mendoni rreth ndryshimeve në cilësinë e shërbimit arsimor që ofroni dhe për rrugët e njohjes së këtyre ndryshimeve. Disa aspekte janë më të thjeshtë për t'u vlerësuar se sa disa aspekte të tjerë. Por, edhe në këtë rast, përpiquni të realizoni vlerësime të sakta, të mbështetura në të dhëna faktike që burojnë nga realiteti i shkollës suaj.

Mendoni me kujdes rreth informacionit që do të pasqyrohet në tabelat e ndryshme. Ky është informacion që përdoret nga inspektorët gjatë inspektimit të shkollës suaj. Nëse ju keni roje në shkollë, atëherë duhet të shënoni emrin e rojes dhe jeni specifik për personin që e menaxhon këtë aktivitet (është pjesë e stafit të shkollës, apo realizohet nga kompani private). Nëse nuk ofrohen të dhëna të tilla, do të krijohen vështirësi për koordinimin e inspektimit të sigurisë së nxënësve me realitetin.

Para se të plotësoni seksionin për efektivitetin e përgjithshëm, lexoni me vëmendje çdo seksion të formatit të vetëvlerësimit. Cilat janë mesazhet që vijnë nga ndikimi i menaxhimit dhe masave

të marra për rezultatet e nxënësve? Ç'kini bërë në të kaluarën për përmirësimin e gjendjes dhe çfarë jeni duke bërë aktualisht?

Jeni specifik. A e keni ofruar atë që e bën të veçantë shkollën tuaj? Që e bën atë ashtu si është?

PARA SE TË DORËZONI VLERËSIMIN TUAJ

1. Lexojeni edhe njëherë;
2. Është i gjatë aq sa duhet?
3. A i jeni përgjigjur të gjitha pyetjeve?
4. A janë të qarta vlerësimet tuaja?
5. A i keni pasqyruar pikëpamjet e të interesuarve për shkollën?
6. A keni ofruar një tablo të paanshme dhe të ndershme të shkollës suaj?
7. A jeni i qartë me aksionet që janë ndërmarrë për përmirësim?
8. Nëse do të ishit inspektor, cilat do të ishin pyetjet që do të bënit për këtë raport vetëvlerësimi?



Manual

Vetëvlerësimi i shkollës

Bashkëpunim i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe organizatës "Save the Children", Programi për Shqipërinë.

Përgatitur në kuadrin e projektit "Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në arsimin bazë 9-vjeçar"



Autor
Vladimir PASKU, Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Ky libër nuk mund të shitet
ose të përdoret për qëllime përfitimi.

Tiranë, 2007